



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 66

2003

Gusht

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9108 datë 17.7.2003	Për substancat dhe preparatet kimike...	2925
Ligj nr.9109 datë 17.7.2003	Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë.....	2940
Vendim i KM nr.523, datë 1.8.2003	Për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave dhe të certifikatave, të fituara në shkollat e larta, të huaja.....	2953
Vendim i KM nr.524, datë 1.8.2003	Për hapjen e shkollës pasuniversitare pranë Akademisë së Policisë "Arben Zylyftari"	2953
Vendim i KM nr.526, datë 1.8.2003	Për pranimin në universitetet dhe në shkollat e larta për vitin akademik 2003-2004, në sistemin me shkëputje nga puna dhe për tarifën e shkollimit po për këtë vit akademik.....	2954
Vendim i KM nr.548, datë 1.8.2003	Për përcaktimin e numrit limit të punonjësve të sektorit të mbledhjes së armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake në Ministrinë e Rendit Publik.....	2960

L I G J
Nr.9108, datë 17.7.2003

PËR SUBSTANCAT DHE PREPARATET KIMIKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë administrimin e substancave dhe të preparateve kimike për mbrojtjen e jetës, shëndetit të njerëzve e të kafshëve, si dhe për mbrojtjen e mjedisit nga rreziqet që mund të shkaktojnë lëndët e rrezikshme.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji është:

a) vendosja e të drejtave dhe detyrimeve të personave juridikë ose fizikë në përcaktimin e vetive dhe klasifikimin e substancave dhe të preparateve kimike për regjistrimin, inventarizimin, njoftimin, menaxhimin dhe tregtimin e tyre;

b) përcaktimi i juridiksionit të zyrave të administratës për marrjen e masave për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve e të kafshëve, si dhe për mbrojtjen mjedisit, kundër efekteve të dëmshme të substancave dhe preparateve kimike për jetën dhe shëndetin, si dhe të vendosë juridiksionin e organeve eksperte të inspektimit, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Neni 3

Ky ligj nuk zbatohet:

a) për produktet mjekësore, ushqimet, ushqimet për blegtorinë, preparatet kozmetike, lëndët e para minerare, municionet, eksplozivat, radiatorët radionuklearë dhe materialet nukleare, produktet për mbrojtjen e bimëve, substancat narkotike dhe psikotrope, armët kimike dhe prekursorët e tyre dhe substancat që dëmtojnë shtresën e ozonit të tokës, të cilat janë objekt i ligjeve të veçanta;

b) për detyrimet në transportin e substancave dhe të preparateve kimike të rrezikshme me hekurudhë, rrugë tokësore, rrugë ujore dhe ajrore, trajtimin e substancave dhe të preparateve nën kontrollin doganor, me kusht që një pjesë e këtij transporti të mos ketë të bëjë me trajtimin ose përpunimin e mbetjeve dhe menaxhimin e ujërave të ndotura dhe ujërave speciale.

Neni 4
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Substanca kimike", që më poshtë do të quhen substanca, janë elementet kimike dhe komponimet e tyre në gjendje natyrore ose të fituara nga një proces prodhimi, përfshirë shtesat dhe solventet kryesore për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre, si dhe ndonjë papastërti me origjinë

natyrore ose të marrë në procesin e prodhimit, me përjashtim të solventeve që mund të veçohen nga substanca pa ndryshuar përbërjen e saj ose pa ndikuar në stabilitetin e saj.

2. "Preparate kimike", që më poshtë do të quhen preparate, janë përzierjet ose solucionet e përbëra nga dy ose më shumë substanca kimike.

3. "Polimer" është substanca, molekulat e së cilës janë formuar nga një varg, prej një ose më shumë njësi monomeresh, që përmbajnë më shumë se gjysmën e peshës së tyre, nga një fraksion i përbërë nga molekula me të paktën tre njësi monomeri, të lidhura me lidhje kovalente me të paktën një njësi monomeri ose një reaktiv tjetër, që përmban më pak se gjysmën e peshës së tij, ose një fraksion me molekula me të njëjtën peshë molekulare.

4. "Njësi monomeri" është forma reaktive e monomerit në molekulën e polimerit.

5. "Klasifikim" është vlerësimi, sipas të cilit substanca ose preparati ka një ose më shumë veti të rrezikshme dhe përcaktimi më tej i kategorive të rrezikut individual.

6. "Shpërndarës" është personi juridik ose fizik, i autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, i cili ruan dhe ua shpërndan substancat ose preparatet personave të tjerë dhe nuk ndikon drejtpërdrejt në vetitë e substancave dhe preparateve, nëpërmjet veprimtarisë së tij.

7. "Vlerësim" është cilësimi i një vetie të rrezikshme, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 5 të këtij ligji.

8. "Importues" është personi juridik ose fizik, vendas ose i huaj, i cili fut në territorin e Republikës së Shqipërisë një substancë ose preparat kimik.

9. "Eksportues" është personi juridik ose fizik, vendas ose i huaj, i cili nxjerr nga territori i Republikës së Shqipërisë një substancë ose preparat kimik.

10. "Tregtim" quhet kalimi i substancave dhe preparateve kimike të një personi tjetër fizik ose juridik. Në kuptim të këtij ligji, në tregtim përfshihet edhe importi.

11. "Tranzit" quhet çdo substancë dhe preparat kimik, që pas hyrjes në territorin shqiptar dhe deri në daljen e tij nga ky territor, nuk i nënshtrohet asnjë lloj procesi ose trajtimi.

12. "Administrimi i substancave dhe preparateve" është një veprimtari, objekt i së cilës janë substancat dhe preparatet, në veçanti, prodhimi, importi, eksporti, tranzitimi, përdorimi, ruajtja, ambalazhimi, etiketimi, transportimi brenda territorit të subjektit, si dhe asgjësimi i tyre.

13. "Regjistrimi i substancave" është regjistrimi i substancave në Regjistrin Kombëtar, që mbahet nga Ministria e Mjedisit, në bazë të të dhënave me shkrim për substancat, në përputhje me këtë ligj.

14. "Rregullore e sigurimit teknik" është një përmbledhje e të dhënave të identifikimit për prodhuesin ose importuesin për substancat ose preparatet e rrezikshme dhe të dhënat që kërkohen për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, të kafshëve dhe të mjedisit.

15. "Sistemi i laboratorëve të akredituar" është një sistem bashkëpunimi ndërkombëtar për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë së praktikës laboratorike, e cila verifikohet dhe miratimi i së cilës konfirmohet me certifikatë.

16. "Substanca dhe preparate të rrezikshme" janë substancat dhe preparatet, që kanë një ose më shumë veti të rrezikshme, të klasifikuara sipas kushteve të vendosura në këtë ligj.

KREU II

Neni 5

Klasifikimi i substancave dhe i preparateve kimike

Substancat dhe preparatet kimike për shkak të vetive, klasifikohen:

1. Eksplozive, që mund të veprojnë në mënyrë ekzotermike, pa praninë e oksigjenit, me zhvillim të shpejtë gazesh ose që vetëndizen dhe digjen shpejt në kushte të caktuara ose që shpërthejnë me ngrohje kur vendosen në kontenierë johermetikë.

2. Oksiduese, që në kontakt me substanca të tjera, në veçanti me substanca të ndezshme, shkaktojnë reaksion ekzotermik të fuqishëm.

3. Ekstremisht të ndezshme, që në gjendje të lëngët kanë pikë flakërimi më të ulët se 0°C dhe pikë vlimi më të ulët se 35°C ose që janë të ndezshme në gjendje të gaztë, në kontakt me ajrin në temperaturë normale të dhomës dhe presion atmosferik normal.

4. Shumë të ndezshme, që:
 - a) mund të nxehen në mënyrë spontane dhe pastaj të digjen në kontakt me ajrin në temperaturë normale të dhomës, presion normal atmosferik dhe pa prani të energjisë;
 - b) mund të digjen lehtësisht në gjendje të ngurtë, si pasojë e një kontakti të shkurtër me një burim zjarri, ndezjeje dhe vazhdojnë të digjen ose të tymosin edhe pas largimit të burimit të zjarrit;
 - c) kanë një pikë ndezjeje në gjendje të lëngët më të ulët se 21°C dhe nuk janë ekstremisht të ndezshme;
 - ç) në kontakt me ujin ose ajrin e lagët çlirojnë gaze shumë të rrezikshme, në sasi të paktën 1 litër/kg.h
5. Të ndezshme, që e kanë pikën e flakërimit 21°C deri në 55°C .
6. Shumë helmuese, që pas thithjes, gjëllitjes ose depërtimit në lëkurë, edhe në sasi të vogla, mund të shkaktojnë dëmtime akute ose kronike të shëndetit, ose vdekje.
7. Helmuese, që pas thithjes, gjëllitjes ose depërtimit në lëkurë, edhe në sasi të vogla, mund të shkaktojnë dëmtime akute ose kronike të shëndetit, ose vdekje.
8. Të dëmshme për shëndetin, që pas thithjes, gjëllitjes ose depërtimit në lëkurë, edhe në sasi të vogla, mund të shkaktojnë dëmtime akute ose kronike të shëndetit, ose vdekje.
9. Korrozive, që në kontakt me indet e gjalla jetësore mund t'i shkatërrojnë ato.
10. Irrituese, që nuk kanë vetitë e substancave korrozive, por që nga kontakti i drejtpërdrejtë për një kohë të gjatë me lëkurën ose membranat mukoze mund të shkaktojnë inflamacione.
11. Sensibilizuese, që pas thithjes, gjëllitjes ose depërtimit në lëkurë mund të shkaktojnë hipersensibilitet dhe, për pasojë, pas një ekspozimi tjetër, shfaqen simptomat karakteristike të tij.
12. Kancerogjene, që pas thithjes, gjëllitjes ose depërtimit në lëkurë mund të shkaktojnë ose të rrisin frekuencën e shfaqjes së kancerit.
13. Mutagjene, që pas thithjes, gjëllitjes ose depërtimit në lëkurë mund të shkaktojnë ose të rrisin frekuencën e shfaqjes së dëmtimeve gjenetike.
14. Dëmtuese për riprodhimin, që pas thithjes, gjëllitjes ose depërtimit në lëkurë mund të shkaktojnë ose të rrisin frekuencën e dëmtimeve në funksionin e riprodhimit ose në aftësinë riprodhuese të meshkujve ose të femrave.
15. Të rrezikshme për mjedisin, që pas futjes në mjedis, përbëjnë ose mund të përbëjnë një rrezik të menjëhershëm ose të mëvonshëm për mjedisin.

Neni 6

1. Në klasifikimin e preparateve nuk duhet të merren parasysh përbërësit, përzierjet, shtesat ose papastërtitë e pranishme në përqendrime:
 - a) më pak se 0,02 për qind në vëllim, nëse kemi të bëjmë me substancë në preparate të gazta, klasifikuar sipas pikës 6 të nenit 5 të këtij ligji;
 - b) më pak se 0,1 për qind në peshë, nëse kemi të bëjmë me substancë të klasifikuar sipas pikave 7, 11, 12, 13 dhe 14 të nenit 5 të këtij ligji, dhe në preparate të tjera, përveç atyre të gazta, sipas pikës 2 të këtij neni;
 - c) më pak se 1 për qind në peshë, nëse substanca është klasifikuar sipas pikave 8, 9, 10 të nenit 5 të këtij ligji.
2. Prodhuesi dhe importuesi janë të detyruar të bëjnë klasifikimin e ri për preparatet me përbërës të njohur:
 - a) nëse për shkak të vlerës absolute të ndryshimit të përqendrimit origjinal të një ose më shumë përbërësve të rrezikshëm të preparatit, është e vlefshme formula e mosbarazimit në aneksin nr.1 të këtij ligji;
 - b) në lidhje me ndryshimet në përbërjen e preparatit, si pasojë e shtimit të substancave ose të zëvendësimit të disa përbërësve të preparatit me një tjetër substancë, pa marrë parasysh rrezikshmërinë e substancës.
3. Prodhuësit dhe importuesit e një substance janë të detyruar të pajisin me të gjitha të dhënat që kërkohen për klasifikimin e preparatit të ri një tjetër person juridik ose fizik, të autorizuar për kryerjen e një veprimtarie tregtare, i cili përdor këtë substancë si përbërës të preparatit të ri.

Neni 7

Testimi i substancave dhe i preparateve kimike

1. Para se të hidhet në treg një substancë e paklasifikuar, prodhuesi ose importuesi është i detyruar të verifikojë nëse substanca ose preparati ka një ose më shumë veti të dëmshme dhe, në bazë të këtij vlerësimi, të klasifikohet substanca ose preparati në grupe të veçanta rreziku, sipas nenit 5 të këtij ligji.

2. Vetitë e substancave dhe të preparateve testohen vetëm me metoda që plotësojnë parimet e mbrojtjes së kafshëve eksperimentale. Metodat për përcaktimin e vetive të rrezikshme caktohen me urdhër të:

a) Ministrisë të Mbrojtjes, për substancat që zotërojnë vetitë e përshkruara në pikat 1 dhe 2 të nenit 5 të këtij ligji;

b) Ministrisë të Shëndetësisë, për substancat që zotërojnë vetitë e dhëna në pikat 6 deri në 14 të nenit 5 të këtij ligji;

c) Ministrisë të Industrisë dhe Energjetikës për substancat që zotërojnë vetitë e dhëna në pikat 3 deri në 5 të nenit 5 të këtij ligji;

ç) Ministrisë të Mjedisit për substancat që zotërojnë vetitë e dhëna në pikën 15 të nenit 5 të këtij ligji.

3. Të dhënat për vetitë e substancave dhe të preparateve të rrezikshme paraqiten nga prodhuesi ose importuesi pas testeve të kryera në laboratorin e akredituar.

4. Procedura për vlerësimin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, mënyra e klasifikimit, ambalazhimit dhe etiketimit dhe lista e substancave të rrezikshme, që do të klasifikohen, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Sistemi i laboratorëve të akredituar

1. Vetitë e rrezikshme të substancave dhe preparateve, sipas këtij ligji, testohen vetëm nga persona juridikë ose fizikë, të autorizuar, të cilët janë të pajisur me certifikatë si laborator i akredituar për këtë qëllim.

2. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, në mbështetje të pikës 1 të këtij neni, janë të detyruar t'i japin ministrisë përgjegjëse të gjitha të dhënat e nevojshme për plotësimin e kushteve, të lëshuara nga laboratorin i akredituar për testimin e substancave të rrezikshme.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, kundrejt pagesës, pajis personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, me certifikatën e laboratorit të akredituar, në bazë të një aplikimi dhe më pas verifikon përputhjen me kërkesat e paraqitura në pikat 4 dhe 5 të këtij neni.

4. Aplikimi përmban:

a) emrin, mbiemrin, emrin e veprimtarisë tregtare, adresën, adresën e veprimtarisë tregtare dhe numrin e identifikimit të aplikantit;

b) emrin, mbiemrin dhe numrin e certifikatës së lindjes së përfaqësuesit ligjor të qendrës së testimit;

c) një vërtetim nga gjykata për përfaqësuesin ligjor të qendrës së testimit, të marrë gjatë tre muajve të fundit;

ç) një deklaratë që aplikanti lejon ministrinë përgjegjëse të verifikojë certifikatën e laboratorit të akredituar.

5. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet t'i paraqesin ministrisë përkatës një program, që siguron një sistem cilësie, sipas parimeve të laboratorit të akredituar.

6. Pas verifikimit të përputhjes me praktikën e laboratorit të akredituar, ministri përkatës, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji, brenda 30 ditëve jep certifikatën e pajtimit me laboratorin e akredituar.

7. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, sipas pikës 1

të këtij neni, të pajisur me certifikatën e laboratorit të akredituar, janë të detyruar të lejojnë personat e autorizuar të hyjnë në mjediset dhe ndërtesat që shërbejnë për testim dhe të japin të dhënat e kërkuara, në kuadër të kontrollit të përputhjes me parimet e praktikës së laboratorit të akredituar.

8. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, të cilët janë të pajisur me certifikatën e pajtimit me parimet e praktikës së laboratorit të akredituar, janë të detyruar të paraqesin rezultatet e testimit, që vërtetojnë se testet janë kryer në përputhje me parimet e laboratorit të akredituar.

9. Ministri përkatës i heq certifikatën e pajtimit si laborator i akredituar personit juridik ose fizik, të autorizuar për të ushtruar këtë veprimtari, në rast se ky person nuk përmbush qoftë edhe njërin nga kushtet, sipas të cilave është dhënë certifikata.

10. Ministri përkatës vendos me rregullore parimet e pajtimit me praktikën e laboratorit të akredituar, procedurën për verifikimin e përputhjes, procedurën për dhënien ose heqjen e certifikatës dhe procedurën e kontrollit të përputhjes me parimet e laboratorit të akredituar.

11. Certifikata e pajtimit të laboratorit të akredituar, e dhënë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ka të njëjtën vlerë me certifikatën e dhënë brenda këtij territori, në rast se plotëson të gjitha kushtet e vëna nga ky ligj dhe nga aktet e tjera normative.

12. Ministrinë e ngarkuara nga ky ligj mbajnë një listë të personave të pajisur me certifikatë të pajtimit me parimet e laboratorit të akredituar dhe e publikojnë këtë listë nga data 30 qershor deri më 31 dhjetor të çdo viti në Buletinin e Ministrisë së Mjedisit.

KREU III REGJISTRIMI I SUBSTANCAVE

Neni 9

Detyrimi për regjistrim

1. Prodhuesi dhe importuesi janë të detyruar të regjistrojnë substancat që hedhin në treg edhe në rastet kur kjo substancë përmbahet në një substancë tjetër si shtesë, përzierje ose papastërti, ose përmbahet në preparat, si një nga përbërësit e tij.

2. Për nevoja të kërimit shkencor dhe zhvillimit nuk është i detyrueshëm, sipas këtij ligji, regjistrimi i substancave që:

a) janë futur në treg nga i njëjti prodhues dhe importues në sasi që nuk i kalon 10 kg në një vit kalendarik, të regjistruar sipas kërkesave për leje veprimtarie, me kusht që kërkesat e regjistrimit të jenë të njëjta me kërkesat e këtij ligji;

b) janë përbërës të preparateve, përzierjeve, shtesave ose papastërtive, përqendrimi i të cilave nuk i kalon vlerat e dhëna në pikën 5 të nenit 7 të këtij ligji;

c) janë të hedhura në treg nga i njëjti prodhues dhe importues, në sasi që nuk i kalon 100 kg në një vit kalendarik, vetëm për nevoja të kërimit shkencor dhe zhvillimit, ose vetëm për përdorim laboratorik;

ç) janë të hedhura në treg nga i njëjti prodhues dhe importues, në sasi që nuk i kalon 1000 kg në një vit kalendarik, vetëm për nevoja të kërimit të aplikuar dhe zhvillimit, brenda një periudhe njëvjeçare;

d) janë produkte të ndërmjetme të prodhimit, të fituara nga reaksionet kimike në sisteme teknike të mbyllura, që nuk janë veçuar dhe larguar nga procesi teknologjik;

dh) janë regjistruar me kushte të njëjta me këtë ligj, kur prodhuesi dhe importuesi i këtyre substancave njofton me shkrim ministrinë përkatëse për kërkesat e shkronjave "a" dhe "ç" të pikës 1 të nenit 10 të këtij ligji.

3. Nëse nga një prodhues dhe importues, sasia e substancës, subjekt i regjistrimit, është më pak se 1000 kg në një vit kalendarik, prodhuesi dhe importuesi, në varësi nga sasia dhe shkalla e rrezikshmërisë së substancës së hedhur në treg, paraqesin dokumentet e regjistrimit në një afat të vendosur në rregulloren e ministrisë së ngarkuar nga ky ligj.

Neni 10

Aplikimi për regjistrim

1. Para hedhjes në treg të substancës që regjistrohet, prodhuesi dhe importuesi paraqesin në ministritë e ngarkuara nga ky ligj një aplikim me shkrim, në gjuhën shqipe.
2. Aplikimi për regjistrim përmban :
 - a) emrin, mbiemrin, gjendjen civile, vendbanimin dhe numrin e identifikimit të personit fizik, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare;
 - b) emrin dhe adresën e tregtarit, të prodhuesit të huaj të substancës së importuar, të detyruar për regjistrim;
 - c) të dhënat bazë për substancën dhe sasinë që regjistrohet;
 - ç) të dhënat për sigurimin teknik të substancës së rrezikshme, që regjistrohet.
3. Hollësitë e tjera, që përfshin aplikimi për regjistrim dhe mënyra e plotësimit të tij vendosen në udhëzimin e ministrit.
4. Prodhuesi dhe importuesi janë të detyruar të njoftojnë brenda 10 ditëve ministrin përkatës për ndonjë ndryshim në të dhënat e aplikimit për regjistrim.
5. Në rast se plotësohen kushtet e vendosura në këtë nen, ministria përkatëse e regjistron substancën brenda 60 ditëve nga paraqitja e aplikimit dhe për këtë njofton aplikantin. Ministria, brenda 30 ditëve, e refuzon zbatimin për regjistrim nëse nuk plotësohen kushtet për regjistrim.
6. Prodhuesit dhe importuesit e substancës, që duhet të regjistrohet, paraqesin protokollet e testeve të kërkuara sipas këtij ligji, të përgatitura nga persona të tjerë, kur ata, njëkohësisht, marrin miratimin me shkrim të personit në fjalë për t'i përdorur këto të dhëna.
7. Ministria e Mjedisit mban Regjistrin Kombëtar për substancat dhe preparatet kimike. Të dhënat për këtë regjistrë sigurohen nga ministritë e ngarkuara nga ky ligj, përveç të dhënave që përbëjnë sekret tregtar.
8. Organizimi dhe struktura e zyrës së regjistrimit të kimikateve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Rregullorja e funksionimit të kësaj zyre miratohet nga Ministri i Mjedisit.
9. Ministritë publikojnë listën e substancave të regjistruara, të paktën një herë në vit, në Buletinin e tyre ose të Ministrisë së Mjedisit.

Neni 11

Ruajtja e sekretit tregtar

1. Të dhënat, publikimi i të cilave dëmton prodhuesin dhe importuesin, me kërkesën e prodhuesit ose të importuesit, konsiderohen gjatë procesit të regjistrimit si sekret tregtar dhe merren vetëm me kërkesë të personave të autorizuar.
2. Detyrimi për ruajtjen e sekretit të të dhënave të konsideruara nga prodhuesi dhe importuesi si sekret tregtar, është i vlefshëm për të gjithë punonjësit që kryejnë testimin e vetive të substancave.
3. Nuk përbën sekret tregtar:
 - a) emërtimi tregtar i substancës;
 - b) emri dhe mbiemri, emërtimi i veprimtarisë tregtare, rezidenca, adresa e tregtarit dhe numri i identifikimit të prodhuesit dhe importuesit të substancës;
 - c) vetitë fiziko-kimike të substancës;
 - ç) udhëzimet për kufizimin e efekteve të rrezikshme të substancës;
 - d) rezultatet përfundimtare të testeve toksikologjike dhe ekotoksikologjike të substancës;
 - dh) shkalla e pastërtisë dhe identifikimi i papastërtive ose i përzierjeve me veti të rrezikshme, sipas nenit 7 të këtij ligji, të realizuara në përputhje me kërkesat e klasifikimit dhe të emërimit të substancës;
 - e) udhëzimet në rastet e rrjedhjes së substancës;
 - ë) të dhënat e sigurimit teknik;
 - f) metodat analitike për substancat e rrezikshme, që lejojnë përcaktimin e tyre në rast ekspozimi në mjedis dhe te njerëzit.

Neni 12
Të dhëna plotësuese

1. Ministri përkatës, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji, u kërkon prodhuesve dhe importuesve të dhëna plotësuese për vetitë e substancës së rrezikshme edhe nëse sasia e substancës ose preparatit kimik, e hedhur në treg nga një prodhues dhe importues, është baras ose më shumë se 10 tonë për një vit kalendarik.

2. Këto të dhëna jepen në rastet kur substanca përmbahet në një tjetër substancë, si përzjerje shtesë a papastërti ose përmbahet në preparat, si përbërës i tij.

KREU IV
ADMINISTRIMI I SUBSTANCAVE DHE I PREPARATEVE TË RREZIKSHME

Neni 13
Vlerësimi i rrezikut të substancave të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin

1. Lista e substancave të rrezikshme, që prej natyrës së tyre përbëjnë një rrezik serioz për jetën dhe shëndetin e njeriut dhe për mjedisin, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Ministria e Mjedisit, së bashku me ministrinë e tjera të ngarkuara nga ky ligj, marrin masa për vlerësimin e rrezikut për jetën dhe shëndetin e njeriut dhe për mjedisin për substancat e përfshira në listë, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Procedura për vlerësimin e rrezikut të substancave të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njeriut përcaktohet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

4. Procedura për vlerësimin e rrezikut të substancave të rrezikshme për mjedisin, përcaktohet me urdhër të Ministrit të Mjedisit.

5. Në bazë të rezultateve të vlerësimit të rrezikut të substancave të rrezikshme, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përkatës, vendos kushtet për hedhjen e këtyre substancave në treg.

Neni 14
**Kushtet e përgjithshme për menaxhimin e substancave
dhe të preparateve të rrezikshme**

1. Në menaxhimin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme çdo person është i detyruar të ruajë shëndetin e njeriut dhe mjedisin, të vendosë shenjat paralajmëruese të rrezikut, me shprehjet që përshkruajnë rrezikun specifik dhe me udhëzimet e sigurimit teknik për menaxhimin e tyre.

2. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, mund t'i menaxhojnë substancat dhe preparatet e rrezikshme, që kanë një ose më shumë veti të rrezikshme, sipas pikave 1, 2, 3, 6, 12, 13, 14 dhe 15 të nenit 5 të këtij ligji dhe t'i trajtojnë këto substanca në sasi më të madhe se 10 tonë për një vit kalendarik, vetëm me leje të ministrisë përkatëse.

3. Menaxhimi i substancave të rrezikshme bëhet pasi është marrë leja nga agjencia rajonale e mjedisit.

4. Personat fizikë mbi moshën 18 vjeç dhe me zotësi juridike për të vepruar, mund të menaxhojnë substancat dhe preparatet e klasifikuara sipas pikave 6, 7, 9, 12, 13 dhe 14 të nenit 5 të këtij ligji.

5. Personat fizikë nga 15 deri në 18 vjeç mund të menaxhojnë substancat dhe preparatet e klasifikuara sipas pikave 6, 7, 9, 12, 13 dhe 14 të nenit 5 të këtij ligji, vetëm në kuadër të përgatitjes profesionale dhe nën mbikëqyrjen e një personi me kualifikim profesional, sipas pikës 2 të nenit 19 të këtij ligji.

6. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, janë të detyruar të lejojnë personat e autorizuar nga zyrat e kontrollit dhe të inspektimit, të hyjnë në mjediset dhe ndërtesat, që përdoren për menaxhimin e substancave dhe të preparateve dhe të marrin të gjitha të dhënat e nevojshme për punën e tyre.

KREU V
HEDHJA NË TREG E SUBSTANCAVE
DHE E PREPARATEVE TË RREZIKSHME

Neni 15

1. Prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi nuk lejohen të hedhin në treg substancat dhe preparatet e rrezikshme, të përfshira në aneksin nr. 2 të këtij ligji.

2. Me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave miraton listën e substancave dhe të preparateve kimike, prodhimi, hedhja në treg dhe përdorimi i të cilave kufizohen ose ndalohen.

Neni 16

1. Personi juridik ose fizik nuk mund t'u shesë konsumatorëve ose t'i japë një personi tjetër, që nuk ka lidhje me veprimtarinë tregtare, substanca dhe preparate të rrezikshme, të klasifikuara sipas pikave 6, 12, 13 dhe 14 të nenit 5 të këtij ligji.

2. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, nuk lejohen t'u shesin konsumatorëve ose t'i japin një personi tjetër substanca dhe preparate të rrezikshme, të klasifikuara sipas pikave 6, 7, 8 dhe 9 të nenit 5 të këtij ligji:

a) personave nën moshën 18 vjeç;

b) personave që u është hequr ose kufizuar zotësia juridike për të vepruar.

3. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare nuk lejohen të shesin substanca dhe preparate të rrezikshme, të klasifikuara sipas pikave 6, 7, 8 dhe 9 të nenit 5 të këtij ligji, në vendqëndrime, në lëvizje, në makina automatike për shitje dhe në kontenierë, të caktuar nga blerësi.

4. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, janë të detyruar që për shitjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, të klasifikuara sipas pikave 6, 7, 8 dhe 9 të nenit 5 të këtij ligji, të sigurojnë vendosjen më vete të këtyre substancave dhe preparateve nga mallrat e tjera. Këto substanca dhe preparate duhet të mbahen vetëm në ambalazhe origjinale, të mbyllura dhe të pathyeshme. Në rastet e shitjes me vetëshërbim, këto mallra nuk lejohen të ekspozohen në vende ku mund të merren lirisht, ato duhet të jepen vetëm nga shitësi.

Neni 17

Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare janë të detyruar, për sa u përket substancave dhe preparateve të rrezikshme, të klasifikuara sipas pikave 6, 7, 9, 12, 13 dhe 14 të nenit 5 të këtij ligji:

a) t'i ruajnë këto substanca dhe preparate nga vjedhjet, humbjet ose nga këmbimi me të tjera substanca dhe preparate të rrezikshme;

b) të sigurojnë pajisjen e mjediseve të ruajtjes me mjete të përshtatshme për ndihmën e parë mjekësore dhe ruajten e personave të shërbimit dhe të dekontaminimit të mjedisit, në përputhje me rregulloren e sigurimit teknik.

KREU VI
AUTORIZIMI PËR MENAXHIMIN E SUBSTANCAVE
DHE TË PREPARATEVE TË RREZIKSHME

Neni 18

1. Personat juridikë ose fizikë, që kryejnë veprimtari tregtare, lejohen të menaxhojnë substancat dhe preparatet e rrezikshme, të klasifikuara sipas nenit 5 të këtij ligji, vetëm nëse kjo veprimtari kryhet në bazë të autorizimit, të marrë në emër të tyre, në përputhje me këtë ligj.

2. Autorizimi nuk lëshohet nëse personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, menaxhojnë substanca dhe preparate të rrezikshme që kanë një ose më shumë

veti të rrezikshme, sipas pikave 5, 8, 9, 10 dhe 11 të nenit 5 të këtij ligji, në sasi më të vogël se 1 ton për një vit kalendarik.

Neni 19

Kushtet për dhënien e autorizimit

1. Ministri përkatës, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji, në bazë të aplikimit me shkrim, lëshon autorizimin, mbështetur në kriteret e kualifikimit profesional dhe të gjendjes shëndetësore, për një person juridik ose fizik, me zotësi të plotë juridike, që ka vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë e që nuk ka kryer vepra penale.

2. Kualifikimi profesional për menaxhimin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme vërtetohet:

me dokumentin e kryerjes së arsimit universitar në fushën përkatëse;

me dokumentin e kryerjes së arsimit të mesëm në fushën përkatëse;

c) me dokumentin e kryerjes së formimit profesional.

3. Rregullat për kualifikimin, procedurën e verifikimit dhe dhënien ose heqjen e autorizimit përcaktohen me urdhër të ministrave përkatës.

4. Autorizimi jepet për një periudhë 2-vjeçare. Autorizimi mund të shtyhet edhe për një 1 vit, me kusht që kërkesa të paraqitet tre muaj përpara mbarimit të afatit. Vendimi për zgjatjen e afatit të autorizimit jepet brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së aplikimit. Kërkesa për zgjatjen e afatit refuzohet për mosplotësim të kushteve.

5. Personat e autorizuar janë të detyruar:

a) të sigurojnë që veprimtaria, për të cilën është lëshuar autorizimi, kryhet nga persona të trajnuar;

b) të sigurojnë se pajisjet e përdorura për kryerjen e veprimtarisë, për të cilën është lëshuar autorizimi, plotësojnë kushtet për mbrojtjen dhe besueshmërinë;

c) t'u japin personave të inspektimit dhe kontrollit të dhëna për kryerjen e veprimtarisë, për të cilën është lëshuar autorizimi.

6. Autorizimi nuk mund të përdoret nga persona të tjerë juridikë ose fizikë.

7. Ministria përkatëse ia heq autorizimin personit juridik ose fizik, nëse, në mënyrë të përsëritur, ai nuk plotëson detyrimet apo nëse ka ndryshim të kushteve, në mbështetje të të cilave është lëshuar autorizimi.

8. Vlefshmëria e autorizimit mbaron:

a) me mbarimin e periudhës kohore për të cilën është dhënë, nëse nuk është shtyrë afati kohor;

b) me heqjen e autorizimit;

c) kur vdes personi fizik;

ç) me humbjen e së drejtës si person juridik.

Neni 20

1. Kur personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare "Asgjësimi i organizmave, bimëve dhe mikroorganizmave të dëmshme dhe eliminimi i faktorëve të tjerë dëmshëm, duke përdorur helme, përfshirë dezinfektimin mbrojtës, kontrollin e insekteve dhe brejtësve, me përjashtim të veprimtarive profesionale në fushën e kujdesit mjekësor" nuk raportojnë në zyrën e licencimit brenda një periudhe kohe të caktuar nga kjo zyrë, për zbatimin e kushteve të autorizimit sipas këtij ligji, autorizimi për kryerjen e tregtimit në këtë fushë bëhet i pavlefshëm.

2. Zyra e licencimit njofton për këtë fakt personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare dhe njëkohësisht zyrën administrative. Kur zyra e licencimit ka dokumente të vlefshme për kualifikimin profesional për një pjesë të veprimtarisë tregtare, merr vendim për ndryshim në licencën e dhënë.

KREU VII
IMPORTI DHE EKSPORTI I SUBSTANCAVE
DHE I PREPARATEVE TË RREZIKSHME

Neni 21

1. Importi dhe eksporti i substancave dhe i preparateve të rrezikshme bëhen vetëm me leje të ministrit përkatës.
2. Importuesit dhe eksportuesit janë të detyruar t'i kërkojnë ministrit përkatës miratimin e lejes për importin dhe eksportin e substancave dhe preparateve të rrezikshme, jo me pak së 60 ditë para datës së kryerjes së importit dhe eksportit. Përmbajtja e aplikimit për dhënien e lejes, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohet më urdher të ministrit.
3. Dhënia e lejes, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, nuk është e nevojshme për substancat dhe preparatet e caktuara, që importohen ose eksportohen në sasi më të vogla se 1 kg për një vit kalendarik, nga një person juridik ose fizik, i autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, për qëllime kërkimi shkencor dhe zhvillimi.
4. Zyra e regjistrimit të kimikateve, në bazë të të dhënave të ministrive të ngarkuara, nga ky ligj, regjistron aplikimet për importin dhe eksportin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme të caktuara, miratimet e dhëna, si dhe njofton Ministrin e Mjedisit për shkëmbimin ndërkombëtar të të dhënave për këto substanca.
5. Menaxhimi i substancave dhe i preparateve të rrezikshme, të caktuara për veprimtari tregtare, kryhet sipas kushteve të nenit 14 të këtij ligji.
6. Eksportuesi është i detyruar të vendosë mbi ambalazhin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, të caktuara për veprimtari tregtare, etiketat në gjuhën e vendit pritës ose të zonës, ku këto substanca e preparate do të përdoren.
7. Importuesit dhe eksportuesit janë të detyruar t'u paraqesin autoriteteve doganore, për kontroll, dokumentet shoqëruese të substancave dhe të preparateve të rrezikshme, të caktuara për veprimtari tregtare.
8. Miratimi për importin dhe eksportin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme të caktuara, i dhënë sipas këtij ligji, nuk mund të zëvendësojë lejen për import ose eksport, të dhënë me ligj të veçantë.

KREU VIII
REGJISTRIMI DHE NJOFTIMI PËR SUBSTANCAT
DHE PREPARATET E RREZIKSHME

Neni 22

1. Prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi i substancave dhe i preparateve të rrezikshme janë të detyruar të regjistrojnë llojin, sasinë, vetitë e substancës dhe të preparatit. Regjistrimi bëhet veçmas për çdo biznes. Mënyra dhe hollësitë e regjistrimit dhe të njoftimit përcaktohen nga zyra e regjistrimit të kimikateve.
2. Prodhuesit dhe importuesit vetëm të substancave të rrezikshme ose që përmbahen në preparat në sasi më të madhe së 10 tonë për një vit kalendarik, janë të detyruar të njoftojnë me shkrim ministrinë përkatëse, brenda datës 15 shkurt të çdo viti, për llojin e substancës së rrezikshme, që prodhojnë ose importojnë, sasinë dhe vetitë e saj.
3. Me kërkesën e personave të autorizuar, në kuadër të detyrimit për njoftim, mund të shënohet si sekret tregtar bërja e njohur e të dhënave që mund t'i shkaktojnë prodhuesit ose importuesit dëme në prodhim ose tregti.
4. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, janë të

detyruar që për menaxhimin e substancave dhe të preparateve të klasifikuara, sipas pikave 6 dhe 7 të nenit 5 të këtij ligji, të njoftojnë agjencinë rajonale të mjedisit, të regjistrojnë hyrjet e këtyre substancave dhe sasinë maksimale të ruajtur. Gjithashtu, ata duhet t'i dërgojnë kësaj agjencie rregulloren e sigurimit teknik për këto substanca. Ky detyrim nuk është i vlefshëm për substancat e përdorura për kërkime shkencore dhe për zhvillim.

5. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, për zhdukjen e organizmave dhe mikroorganizmave të dëmshëm, janë të detyruar që, për përdorimin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, të klasifikuara sipas pikave 6 dhe 7 të nenit 5 të këtij ligji, të njoftojnë me shkrim agjencinë rajonale të mjedisit dhe zyrën përkatëse të bashkisë, ku do të kryhet kjo veprimtari, 48 orë përpara fillimit të saj. Brenda kësaj periudhe kohore nuk përfshihen ditët e festave, të fundjavës dhe ditët e pushimeve.

6. Agjencia rajonale e mjedisit së bashku me njësinë vendore të mbrojtjes së shëndetit përcaktojnë, 24 orë para fillimit të veprimtarisë, për të cilin është bërë njoftimi, kushtet e veçanta për kryerjen e kësaj veprimtarie, sipas pikës 5 të këtij neni.

Neni 23

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) mbikëqyr zbatimin e rregullave juridike dhe të udhëzimeve të Ministrit të Mjedisit e të zyrave të tjera administrative në fushën e mbrojtjes së mjedisit, gjatë menaxhimit të substancave dhe të preparateve të rrezikshme, nga personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare;

b) përcakton kushtet për shmangien e mangësive në menaxhimin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme gjatë punës inspektuese;

c) vendos gjoha për personat juridikë ose fizikë, në raste shkeljesh të detyrimeve në fushën e mbrojtjes së mjedisit, gjatë menaxhimit të substancave dhe të preparateve të rrezikshme;

ç) i propozon ministrisë përkatëse ndërprerjen e veprimtarisë së personit të autorizuar, maksimumi për 30 ditë, në qoftë se ai nuk përmbush kushtet e autorizimit. Nëse nuk respekton kushtet, në bazë të të cilave është lëshuar autorizimi, propozon heqjen e tij;

d) i sugjeron Ministrit të Mjedisit kryerjen e inspektimit të lartë shtetëror, në fushën e mbrojtjes së mjedisit, për menaxhimin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme;

dh) bashkëpunon me autoritetet doganore dhe u siguron atyre asistencë me specialistë.

e) ngarkon inspektorët për kryerjen e detyrës inspektuese. Gjatë kryerjes së detyrës inspektorët vërtetojnë identitetin e tyre me anë të dokumentit të inspektorit në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit.

Neni 24

Inspektorati Sanitar Shtetëror

Inspektorati Sanitar Shtetëror ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) kontrollon zbatimin e rregullave juridike dhe të vendimeve në fushën e mbrojtjes së jetës dhe të shëndetit të njeriut gjatë menaxhimit të substancave dhe të preparateve të rrezikshme, si dhe përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara për regjistrimin e substancave, nga personat juridikë ose fizikë;

b) kërkon nga personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, ndreqjen e parregullsive në fushën e menaxhimit të substancave dhe të preparateve, me veti të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njeriut, në përputhje me detyrimet e përcaktuara për regjistrimin e substancave, si dhe përcakton afatin e fundit të rregullimeve;

c) vendos gjohat për personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare;

ç) jep mendim për lëshimin e autorizimit për menaxhimin e substancave të klasifikuara, sipas pikave 6, 7, 8, 9, 10, 13 dhe 14 të nenit 5 të këtij ligji;

d) bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit dhe me autoritetet doganore, si dhe u siguron atyre asistencë me specialistë.

Neni 25
Administrata doganore

1. Autoritetet doganore kontrollojnë në pikat e kalimit të kufirit shtetëror mallin e deklaruar si substancë dhe preparat i rrezikshëm, për importin dhe eksportin e të cilave kërkohet miratim nga ministria përkatëse e përcaktuar nga ky ligj.

2. Në rast dyshimi apo shkeljeje të këtij ligji, autoritetet doganore bllokojnë mallin dhe njoftojnë Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit ose Inspektoratin Sanitar Shtetëror për kundërvajtjen dhe, në rast dyshimi, u kërkojnë këtyre inspektorateve asistencë teknike.

3. Autoritetet doganore regjistrojnë ngarkesën me substanca dhe preparate të rrezikshme, që kalon kufirin shtetëror.

4. Autoritetet doganore u lejojnë punonjësve të Ministrisë së Mjedisit dhe të inspektorateve shqyrtimin e regjistrave, në kopje të shkruara ose fotokopje, si dhe transmetimin dixhital të të dhënave.

KREU IX
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT

Neni 26

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

1. Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Inspektorati Sanitar Shtetëror vendosin gjoba nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë për personin juridik ose fizik, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, i cili:

a) nuk vepron në përputhje me kushtet për menaxhimin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, sipas pikave 1, 4 dhe 5 të nenit 14 të këtij ligji;

b) shet ose jep substanca dhe preparate të rrezikshme, të klasifikuara sipas pikave 6, 12, 13 dhe 14 të nenit 5 të këtij ligji.

2. Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Inspektorati Sanitar Shtetëror vendosin gjoba nga 50 000 deri në 500 000 lekë për importuesin dhe prodhuesin, i cili:

a) nuk i klasifikon substancat dhe preparatet para hedhjes në treg dhe nuk plotëson detyrimet sipas pikave 1 dhe 4 të nenit 7 të këtij ligji;

b) nuk jep të dhënat e kërkuara për klasifikimin e një preparati të ri, sipas pikës 5 të nenit 7 të këtij ligji.

3. Inspektorati Shtetëror i Mjedisit vendos gjoba nga 1 000 000 deri në 10 000 000 lekë, në varësi të shkeljes, për personin juridik ose fizik, i cili:

a) teston vetitë e substancave dhe të preparateve të rrezikshme në kundërshtim me metodat e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji;

b) nuk vepron në mbështetje të parimeve të sistemeve të laboratorëve të akredituar, sipas nenit 8 të këtij ligji;

c) nuk vepron sipas kushteve të caktuara në autorizimin për menaxhimin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme;

ç) nuk vepron sipas të gjitha kushteve për menaxhimin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, sipas nenit 14 të këtij ligji;

d) nuk regjistron dhe nuk jep të dhëna për substancat dhe preparatet e rrezikshme.

4. Inspektorati Shtetëror i Mjedisit vendos gjoba nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë për personin juridik ose fizik, i cili hedh në treg një substancë të paregjistruar, që është e detyrueshme të regjistrohet, sipas neneve 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14 të këtij ligji.

5. Inspektorati Shtetëror i Mjedisit ose Inspektorati Sanitar Shtetëror vendos gjoba nga 10 000 000 deri në 50 000 000 lekë për një prodhues ose importues, i cili:

a) nuk plotëson kërkesat e caktuara për ambalazhimin dhe etiketimin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme;

b) nuk plotëson kushtet e caktuara për hedhjen në treg të substancave dhe të preparateve të rrezikshme, sipas neneve 15, 16 dhe 17 të këtij ligji;

c) nuk plotëson kushtet për importin ose eksportin e substancave dhe të preparateve të

rrezikshme të caktuara, sipas nenit 21 të këtij ligji;

ç) bën deklarime të rreme për përputhjen me certifikatën e pajtimit të laboratorit të akredituar, sipas pikës 8 të nenit 8 të këtij ligji;

d) i jep të pasakta të dhënat e kërkuara nga ky ligj.

6. Inspektoratet përkatëse, për shkelje të përsëritura, e gjobisin personin juridik ose fizik, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, me dyfishin e vlerës së caktuar më sipër, si dhe me mbylljen e veprimtarisë, heqjen e licencës dhe sekuestrimin e produkteve të rrezikshme.

7. Shkelje e përsëritur është shkelja e detyrimeve, e kryer brenda një periudhe dyvjeçare nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të mëparshëm për vënien e gjobës.

8. Gjoha vendoset nga organi administrativ, i cili fillon i pari procesin. Në qoftë se procesi fillon njëkohësisht, në të njëjtën datë, nga më shumë se një organ administrativ, procesi i vënies së gjobës realizohet nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit. Gjoha ekzekutohet nga zyra financiare përkatëse.

9. Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit, te ministri përkatës, i cili duhet t'i përgjigjet ankimit brenda 15 ditëve nga depozitimi i tij.

10. Kundër vendimit të ministrit ose kur ky i fundit nuk përgjigjet brenda afatit 15-ditor, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve.

11. Gjohat e vëna nga inspektoratet derdhen në Buxhetin e Shtetit dhe likuidohen brenda 30 ditëve nga data e vendimit të formës së prerë. Për çdo ditë vonesë, pas plotësimit të këtij afati, kundërvajtësi detyrohet të paguajë, përveç gjobës, një shumë të barabartë me 2 për qind të gjobës.

KREU X DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 27

1. Dispozitat e krerëve II, V, VI, VII dhe VIII zbatohen brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Dispozitat e kreut III zbatohen brenda dy vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Dispozitat e kreut IX zbatohen brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Brenda 2 viteve nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave përcakton listën e substancave të rrezikshme, sipas nenit 13 pika 1 të këtij ligji.

5. Personat fizikë, të kualifikuar profesionalisht për menaxhimin e helmeve, sipas rregullave juridike ekzistuese, vlerësohen të tillë sipas pikës 2 të nenit 19, edhe për menaxhimin e substancave dhe të prepareteve të klasifikuara, sipas pikave 6 e 7 të nenit 5, për një periudhë prej tre vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

6. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, që merren me tregtinë e cilësuar "Prodhim i helmeve dhe substancave korrozive, me përjashtim të helmeve të rrezikshme speciale" ose "Shitja e helmeve, substancave korrozive dhe pesticideve", në bazë të licencës për tregtinë e vogël, të nxjerrë para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, lejohen të vazhdojnë tregtinë, për një periudhë prej një viti pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

7. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, janë të detyruar të vërtetojnë përputhjen me kushtet e autorizimit, sipas këtij ligji, brenda një periudhe njëvjeçare nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Zyra e licencimit, kur mungojnë kushtet e kualifikimit profesional, bën ndryshime në licencën e dhënë.

8. Kur personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare nuk vërtetojnë në zyrën e licencave ushtrimin e veprimtarisë në përputhje me kushtet, autorizimi i lëshuar për kryerjen e veprimtarisë së tyre tregtare mbaron në datën e përfundimit të periudhës njëvjeçare, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Zyrat e licencimit njoftojnë personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare dhe zyrën administrative përkatëse për përfundimin e periudhës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, të përcaktuar në autorizim.

9. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, që zhvillojnë tregtinë e lejuar "Asgjësimi i organizmave, bimëve dhe mikroorganizmave të dëmshëm dhe eliminimi

i faktorëve të tjerë dëmtues duke përdorur helmet, përfshirë dezinfektimin mbrojtës, kontrollin e insekteve dhe brejtësve, me përjashtim të veprimtarive profesionale në fushën e kujdesit mjekësor" ose "Prodhimi i helmeve të rrezikshme speciale", në bazë të licencës së nxjerrë para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund ta vazhdojnë këtë tregti deri një vit nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

10. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, janë të detyruar që, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të vënë në dijeni zyrën e licencimit për zbatimin e kushteve të autorizimit, sipas këtij ligji. Me mbarimin e këtij afati autorizimi është i pavlefshëm.

Zyra e licencimit njofton për këtë fakt personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare dhe, njëkohësisht, zyrën administrative.

Nëse kjo zyrë e gjykon se janë plotësuar kushtet, merr vendim për ndryshime në licencën e dhënë.

Neni 28

Akte të tjera të nevojshme

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7 pika 4, 10 pika 8, 13 pikat 1 dhe 5 dhe 15 pika 2 të këtij ligji.

Neni 29

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3922, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

ANEKSI NR.1

Limitet për ndryshimin e klasifikimit të preparateve kimike

Vlera absolute e ndryshimit të përqendrimit origjinal, e shprehur në përqindje në peshë për substancat e ngurta dhe të lëngëta ose në volum për substancat e gazta jepet:

$$|C2 - C1| > K \cdot C1$$

|C2 - C1| - është vlera absolute e ndryshimit të përqendrimit origjinal të komponentit (në %)

K - koeficienti i dhënë në tabelën më poshtë

C1 - përqendrimi origjinal i komponentit (në %)

C2 - përqendrimi i ri i komponentit (në %)

Përqendrimi origjinal C1	Koeficienti K
$C1 \leq 2,5$	0,150
$2,5 < C1 \leq 10 \%$	0,100
$10\% < C1 \leq 25 \%$	0,060
$25\% < C1 \leq 50 \%$	0,050
$50\% < C1 \leq 100 \%$	0,025

ANEKSI NR.2

Ndalohen në Republikën e Shqipërisë:

prodhimi, importimi, eksportimi dhe shpërndarja e këtyre substancave

Emri i substancës	Cas Numër
Bifenile të poliklorinuara (PCB) dhe preparate me përmbajtje të kësaj substance në sasi më të madhe se 0,005 % (me përjashtim të bifenileve të mono dhe dikloruara)	1336-36-3
Trefenile të poliklorinuara (PTC) dhe preparate me përmbajtje të kësaj substance në sasi më të madhe se 0,005 %	61788-88-8
Fibra azbesti krocidolit b) amozit c) antrofilit ç) aktonolit d) tremolit	12001-28-4 12172-73-5 77536-67-5 77536-66-4 77536-68-6
Monometil tetraklordifenil metan (emri tregtar Ugilec 141)	75623-60-6
Monometil diklordifenil metan (emri tregtar Ugilec 141)	
Monometil dibromdifenil metan (emri tregtar DBBT)	99688-47-8

Shënim: CAS – Chemical Abstract Service

L I G J
Nr.9109, datë 17.7.2003

PËR PROFESIONIN E AVOKATIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I
PJESA E PËRGJITHSHME

Neni 1

Avokatia në Republikën e Shqipërisë është profesion i lirë, i pavarur, i vetërregulluar dhe i vetëdrejtuar.

Neni 2

Avokati jep ndihmë juridike nëpërmjet:

- a) këshillimit ligjor për çështje të ndryshme;
- b) përgatitjes së kërkesëpadive ose të kërkesave gjatë procedimit penal, si dhe të kërkesave ankimore, rekurseve kundër vendimeve gjyqësore, atyre të organit të prokurorisë, arbitrazhit ose të organeve të administratës publike;
- c) përgatitjes së kërkesave drejtuar Gjykatës së Apelit, Gjykatës Kushtetuese, gjykatave ndërkombëtare dhe çdo organizmi në të cilin aderon Republika e Shqipërisë;
- ç) përgatitjes së ankesave dhe kërkesave të personave fizikë ose juridikë;
- d) përpilimit të akteve që i nënshtrohen veprimeve noteriale;

dh) hartimit të kontratave e të marrëveshjeve, si dhe të çdo dokumenti tjetër që sjell ose synon të sjellë pasoja juridike;

e) pranisë si mbrojtës në kohën e shoqërimit, ndalimit, arrestimit, gjatë procesit të hetimit, shqyrtimit gjyqësor të personave në çështjet penale;

ë) përfaqësimit të personave fizikë ose juridikë në çështjet civile dhe administrative, në gjykatë, në arbitrazh dhe në organe të tjera të administratës publike;

f) veprimeve të tjera të ndihmës juridike që parashikohen në ligj.

Neni 3

1. Avokati ushtron profesionin e tij individualisht ose në bashkëpunim me avokatë të tjerë, duke u organizuar në zyra avokatie.

2. Avokati nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një zyre avokatie.

Neni 4

Avokati, gjatë ushtrimit të profesionit të tij, nuk mund të jetë, njëkohësisht, gjyqtar, prokuror, noter, nëpunës civil ose punonjës i administratës publike.

Neni 5

1. Avokati mund ta ushtrojë profesionin e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe përpara çdo gjykate, prokurorie ose organi të administratës publike.

2. Avokati mund ta ushtrojë profesionin e tij edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin e shtetit ku jepet ndihma juridike.

KREU II TË DREJTAT DHE DETYRAT E AVOKATIT

Neni 6

1. Avokati, në funksion të ushtrimit të profesionit të tij, ka të drejtë të kërkojë nga institucionet e administratës publike, në përputhje me ligjin, shpjegime, të dhëna dhe dokumente, që kanë lidhje me çështjen ose personin që përfaqësohet ose mbrohet prej tij.

2. Institucionet e administratës publike, sipas kompetencës dhe procedurave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre, janë të detyruara të përmbushin kërkesat e avokatit.

3. Në rast të mospërmbushjes së detyrimit të institucioneve të administratës publike ose nga entet e tjera jopublike, avokati ka të drejtë të paraqesë brenda 5 ditëve në gjykatë kërkesën për realizimin e detyrimit nëpërmjet një vendimi gjyqësor.

Neni 7

1. Avokati ka të drejtë të takojë personin e mbrojtur prej tij, në mënyrë private dhe pa kufizim kohor, në çdo gjendje të kufizimit të lirisë personale. Organet kompetente kanë të drejtë të mbikëqyrin takimin ndërmjet avokatit dhe personit të mbrojtur, por, në çdo rast, u ndalohet të dëgjojnë bashkëbisedimin ndërmjet tyre.

2. Organi i prokurorisë, gjykata, administrata e burgjeve dhe Policia e Shtetit janë të detyruara të sigurojnë praninë e avokatit, kur këtë e kërkon personi i mbrojtur prej tij, i ndaluar, i arrestuar ose që është duke vuajtur dënimin. Në të gjitha rastet, prania e avokatit duhet të sigurohet menjëherë.

3. Avokati nuk ka të drejtë t'i kërkojë dhe t'i ofrojë ndihmë juridike një personi të ndaluar ose të arrestuar, pa kërkesën e këtij të fundit.

Neni 8

Avokati ka të drejtë, në përputhje me procedurat hetimore, të marrë pjesë në proces, të pyesë personin e mbrojtur prej tij, dëshmitarët dhe ekspertët, të lexojë dhe të njohë në përfundim të hetimit të gjitha aktet e dokumentet, që janë të lidhura me çështjen dhe t' i nënshkruajë ato.

Neni 9

1. Avokati ka për detyrë ta ushtrojë profesionin e vet me ndershmëri dhe dinjitet, të respektojë rregullat e etikës profesionale dhe të përdorë të gjitha mjetet e ligjshme për mbrojtjen me besnikëri të të drejtave dhe të interesave të personave që mbrohen ose përfaqësohen prej tij.

2. Avokati duhet të sigurojë që asnjë konflikt interesash nuk ekziston ndërmjet tij dhe personit që mbron ose përfaqëson.

3. Avokatit i ndalohet të bëjë publike të dhënat, që i ka mësuar nëpërmjet personit të mbrojtur ose të përfaqësuar prej tij ose nga dokumentet që ky i fundit i ka vënë në dispozicion, në funksion të mbrojtjes së kërkuar, me përjashtim të rastit kur ai ka dhënë miratimin e tij me shkrim.

4. Avokatit i ndalohet të bëjë kallëzim në organin e ndjekjes penale dhe nuk mund të pyetet si dëshmitar për personin, të cilit i ka kryer shërbime dhe ndihmë juridike, si dhe për rrethana që ai i ka mësuar gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit.

5. Avokatit i ndalohet të marrë pjesë në një çështje, kur ai ka qenë i ngarkuar më parë në të si gjykatës, prokuror, oficer i Policisë Gjyqësore ose si dëshmitar.

6. Avokati nuk lejohet të japë ndihmë ligjore ose të përfaqësojë një person, kur ka këshilluar ose ka përfaqësuar më parë palën kundërshtare në të njëjtën çështje, ose kur avokati ka lidhje gjaku apo ka interes të njëjtë me palën kundërshtare.

7. Avokatët, që shërbejnë në të njëjtën zyrë avokatie, nuk lejohen të përfaqësojnë palët kundërshtare në të njëjtën çështje.

8. Avokatët, që ushtrojnë profesionin e tyre pranë së njëjtës zyre avokatie, prezumohet se janë në dijeni dhe zotërojnë dokumentet për këdo që është mbrojtur apo përfaqësuar nga zyra e tyre.

9. Përveç rasteve të parashikuara më sipër në këtë nen, avokati është i detyruar të sigurohet se nuk vepron në konflikt me interesat e personit që mbrohet ose përfaqësohet prej tij. Kur avokati dyshon se është duke vepruar në konflikt interesash, ai duhet të marrë miratimin me shkrim nga palët, të cilat mendohet se preken nga ky konflikt interesash.

Neni 10

Avokatët, në përputhje me dokumentacionin standard, të miratuar nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, duhet të mbajnë një libër shënimesh ku shënohen të gjitha shërbimet ligjore të dhëna, kontratat, me shkrim, duke përdorur sistemin numerik, emrin e tij, si dhe emrin e zyrës së avokatisë.

Neni 11

1. Shpërblimi i avokatit për punën e kryer caktohet në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) me marrëveshje ndërmjet tij dhe palës së mbrojtur ose të përfaqësuar prej tij;

b) nga gjykata ose prokuroria, kur ai është caktuar kryesisht ose kur personi i mbrojtur ose i përfaqësuar nuk ka mundësi financiare dhe ndihma ligjore për të është falas.

Masa e shpërblimit për këto raste përcaktohet me vendim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

c) me ligj.

2. Në të gjitha rastet, avokatit nuk i lejohet të marrë shpërblim tjetër.

Neni 12

1. Avokati nuk mund të kërkojë nga personi që mbron ose përfaqëson, që të shpërblehet prej tij me përqindje gjatë procesit të gjykimimit.

2. Shpërblimi me përqindje, i parallogaritur ose jo, mund të paguhet vetëm kur është parashikuar në marrëveshjen ndërmjet avokatit dhe personit që ai mbron ose përfaqëson, për rastin

mbrojtjes apo përfaqësimit të suksesshëm të çështjes.

3. Avokatit i lejohet të paguhet me komision në rastet kur siguron kthimin e huasë për personin që mbrohet ose përfaqësohet prej tij jogjyqësisht.

Neni 13

1. Nëse avokati vendos të heqë dorë nga përfaqësimi ose mbrojtja e mëtejshme e një personi, është i detyruar ta njoftojë atë 15 ditë përpara mbarimit të shërbimit nga ana e tij.

2. Avokati është i detyruar t'i shërbejë klientit të tij gjatë periudhës 15-ditore para mbarimit të shërbimit dhe t'i njoftojë atij çdo të dhënë për çdo shumë parash, prona apo kompensim që avokati mban për klientin.

3. Brenda 15 ditëve nga dhënia e njoftimit, avokati duhet t'i kthejë klientit të gjitha dokumentet e lidhura me çështjen ose t'i dërgojë ato në adresën e treguar nga avokati i ngarkuar rishtas. Gjithashtu, avokati është i detyruar t'i kthejë klientit parapagimin që ka marrë prej tij, përveç kur, bashkërisht, merren vesh ndryshe.

Neni 14

Nëse personi, që përfiton ndihmën juridike nga avokati, vendos të zgjidhë kontratën përpara përfundimit të çështjes ose shërbimit, avokati ka të drejtën të kërkojë shpërblimin për punën e kryer.

Neni 15

Avokati ka të drejtë të transferohet nga një dhomë në një dhomë tjetër avokatie, për sa kohë që paguan kontributet përkatëse të anëtarësisë. Në këtë rast ai duhet të marrë një miratim, si nga dhoma që largohet, ashtu edhe nga dhoma ku ai dëshiron të bëhet anëtar.

Neni 16

1. Avokati, kryesisht apo për shkak të ligjit, duhet të heqë dorë përkohësisht nga ushtrimi i profesionit të tij, për aq kohë sa është në marrëdhënie pune me administratën publike.

2. Për të gjitha rastet e treguara në pikën 1 të këtij neni, avokati duhet të njoftojë me shkrim dhomën e avokatëve ku bën pjesë.

3. Në rast të ndërprerjes së ushtrimit të profesionit të avokatit për arsye të moshës ose shëndetit, nëse nuk ushtron një veprimtari tjetër, avokati ka të drejtë të jetë anëtar i dhomës së avokatisë, si dhe të marrë pjesë në veprimtaritë që organizohen prej saj.

KREU III

ORGANET DREJTUESE DHE KOMPETENCAT E DHOMËS KOMBËTARE TË AVOKATISË DHE TË DHOMAVE TË AVOKATISË

Neni 17

1. Dhoma Kombëtare e Avokatisë është person juridik, që ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga shteti.

2. Dhoma Kombëtare e Avokatisë përgjigjet për rregullimin dhe kontrollin e ushtrimit të profesionit të avokatit në Republikën e Shqipërisë.

3. Rregullat e hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë parashikohen në statutin e saj.

4. Dhoma Kombëtare e Avokatisë është përgjegjëse për themelimin e dhomave të avokatisë. Numri minimal i avokatëve, që mund të formojnë një dhomë avokatie, caktohet në Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

5. Çdo avokat mund të jetë anëtar vetëm i një dhome avokatie. Çdo dhomë është e përbërë nga avokatë, të cilët janë anëtarë të saj dhe që praktikojnë ose kanë praktikuar për herë të fundit profesionin e avokatit në juridiksionin e saj.

6. Çdo dhomë avokatie ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur, duke respektuar

rregullat e parashikuara në ligj dhe në statutin e vendimet e tjera, të miratuara nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Neni 18

Organet drejtuese të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe të dhomave të avokatisë janë, përkatësisht, Këshilli i Përgjithshëm dhe Këshilli Drejtues.

Neni 19

1. Organi më i lartë i përfaqësimit dhe vendimmarrjes së Dhomës Kombëtare të Avokatisë është Këshilli i Përgjithshëm.

2. Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë përbëhet nga jo më pak se një përfaqësues i zgjedhur për këtë qëllim nga çdo dhomë avokatie, sipas statutit.

3. Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë ushtron këto kompetenca:

a) miraton Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

b) miraton "Kodin e etikës së avokatit";

c) përcakton, duke u bazuar në kriterin e vjetërsisë në profesionin e avokatit, të aftësive profesionale të treguara dhe në edukimin profesional e akademik të posaçëm dhe pas konsultimeve me Ministrin e Drejtësisë, listën e avokatëve që mund të ushtrojnë profesionin e tyre përpara gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, si dhe në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese. Kriteret më të hollësishme për këtë përzgjedhje përcaktohen në Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

ç) zgjedh jo më pak se 5 anëtarë të saj në Këshillin Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

d) cakton kontributin që derdhin dhomat e avokatisë në Dhomën Kombëtare të Avokatisë;

dh) shqyrton dhe miraton llogaritë vjetore dhe buxhetin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

e) analizon veprimtarinë e dhomave të avokatisë, nëse ajo është në përputhje me këtë ligj dhe me Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

ë) ndihmon e bashkërendon veprimtaritë e dhomave të avokatisë, në mënyrë që të garantojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të avokatëve, si dhe të dhomave të avokatisë;

f) miraton rregullat e përgjithshme për zhvillimin e provimit të kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatit;

g) miraton rregullat dhe kushtet që duhet të përmbushen nga asistentët në periudhën e stazhit për avokat, si dhe për trajnimin profesional të tyre.

4. Vendimet e Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, për miratimin e akteve të parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 3 të këtij neni, quhen të miratuara kur për to kanë votuar jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 20

1. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve Kryetarin, Zëvendëskryetarin dhe Sekretarin e Përgjithshëm të tij.

2. Rregulla më të hollësishme për organizmin dhe funksionimin e administratës mbështetëse të Këshillit Drejtues, caktohen në statut.

3. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë ushtron këto kompetenca:

a) thërret Këshillin e Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

b) përgatit Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

c) përgatit "Kodin e etikës së avokatit";

ç) përfaqëson Dhomën Kombëtare të Avokatisë në marrëdhënie më të tretët, sipas rregullave të caktuara në statut;

d) përgatit llogaritë vjetore për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

dh) shqyrton dhe miraton kërkesat për lejimin e ushtrimit të profesionit të avokatisë;

e) revokon me ose pa afat, ose heq lejen për ushtrimin e profesionit të avokatit, në përputhje

me ligjin dhe Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

ë) merr masa për ndjekjen e vazhdueshme të zbatimit të vendimeve të marra nga Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Neni 21

Këshilli i përgjithshëm i çdo dhome avokatie ka këto kompetenca:

- a) zgjedh përfaqësues të saj në Këshillin e Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në përputhje me numrin maksimal të pjesëmarrjes, të vendosur nga kjo e fundit;
- b) zgjedh anëtarët e Këshillit Drejtues, kryetarin dhe sekretarin e dhomës;
- c) shqyrton dhe analizon ecurinë në punë dhe trajnimin profesional të avokatëve dhe të asistentëve, që bëjnë pjesë në dhomën e avokatisë;
- ç) promovon tek anëtarët e saj mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, të ligjit, statutit dhe "Kodit të etikës së avokatit";
- d) përfaqëson dhe mbron interesat e anëtarëve të saj;
- dh) shqyrton dhe nëse çmon, miraton vendimet e marra nga Këshilli Drejtues i dhomës së avokatisë;
- e) mban regjistrin e anëtarëve, që ushtrojnë apo kanë ushtruar profesionin e avokatit në atë juridiksion, si dhe njofton Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Ministrinë e Drejtësisë për çdo ndryshim në përbërjen e saj.

Neni 22

Këshilli Drejtues i dhomës së avokatisë ushtron këto kompetenca:

- a) thërret mbledhjen e përgjithshme të dhomës së avokatisë;
- b) përgatit çdo vit llogaritë vjetore, për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Përgjithshëm;
- c) trajton çdo kërkesë për anëtarësi dhe, nëse çmon, i rekomandon Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhënien e lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit;
- ç) shqyrton dhe miraton statutin e zyrave të avokatisë, që vendosen në juridiksionin e saj, kur çmon përputhshmërinë e tij me ligjin dhe rregullat e miratuara nga Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë;
- d) cakton, me pëlqimin e tyre, avokatin apo zyrën e avokatisë, ku stazhieri do të përmbushë detyrimet e tij;
- dh) cakton avokat për të ndjekur çështjet gjyqësore, kur i kërkohet nga gjykata;
- e) cakton një avokat, që të marrë përsipër çështje, të cilat janë braktisur nga një avokat i mëparshëm dhe klienti nuk ka mundur të gjejë një tjetër;
- ë) shqyrton ankesat kundër asistentëve të avokatëve, që ushtrojnë profesionin në juridiksionin e vet, si dhe merr masa disiplinore që i çmon të përshtatshme, në përputhje me ligjin, "Kodin e etikës së avokatit" dhe të statutit të vetë dhomës së avokatisë;
- f) përmbush detyra të tjera të parashikuara në statutin e dhomës së avokatisë apo i që i caktohen nga Këshilli i Përgjithshëm i saj.

Neni 23

1. Dhoma mund të hapë llogari bankare në një bankë, që është e licencuar të ushtrojë biznes bankar në Republikën e Shqipërisë, për të mbajtur paratë e klientëve të ndryshëm të avokatëve anëtarë të dhomës, si garanci bankare për çështje që parashikojnë pagesa të mëdha.

2. Tërheqja e shumave nga ajo llogari duhet të kryhet me dy firma, njëra nga të cilat duhet të jetë nga kryetari, zëvendëskryetari ose sekretari i përgjithshëm i dhomës dhe firma tjetër duhet të jetë nga klienti përkatës. Interesi bankar i përfituar nga ky operacion duhet t'i kalojë dhomës.

KREU IV ZYRA E AVOKATISË

Neni 24

1. Kur dy ose më shumë avokatë dëshirojnë të themelojnë një zyrë avokatie, ata, fillimisht, duhet të dërgojnë aktin e themelimit dhe statutin e saj për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

2. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë duhet të miratojë statutin e zyrës së avokatisë brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës. Nëse ai nuk është dakord me statutin e paraqitur, ajo duhet t'ia kthejë të interesuarit modelin e paraqitur së bashku me kërkesën e saj për ndryshimet, që dhoma mendon se i duhen bërë statutit. Aplikanti duhet të kthejë projektin e ndryshuar brenda 15 ditëve.

3. Zyra e avokatisë, nëse e sheh të arsyeshme dhe brenda interesit të vet, pasi është miratuar si e tillë nga dhoma, mund t'i drejtohet gjykatës për t'u njohur si person juridik, sipas ligjit për shoqëritë tregtare.

KREU V KUSHTET PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË AVOKATIT

Neni 25

Profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë mund ta ushtrojë çdo shtetas shqiptar që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) të ketë kryer arsimin e lartë juridik brenda vendit ose jashtë vendit, por të njësuar me të;
- b) të jetë regjistruar në një dhomë avokatie dhe në Ministrinë e Drejtësisë si asistent pranë një avokati, të ketë përfunduar periudhën njëvjeçare të stazhit dhe të ketë marrë mendimin pozitiv të avokatit;
- c) të ketë marrë më shumë se 50 për qind të pikëve në provimin e kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatisë;
- ç) të gëzojë integritet moral dhe qytetar, për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe të plotësojë kërkesat e etikës për ushtrimin e profesionit të avokatit;
- d) të mos jetë dënuar për vepra penale të kryera me dashje, sipas parashikimeve të "Kodit të etikës së avokatit";
- dh) të mos jetë pjesëmarrës në marrëdhënie apo veprimtari publike ose private, të cilat, sipas ligjit, Statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe "Kodit të etikës së avokatit", janë të papajtueshme ose të papërshtatshme me figurën dhe ushtrimin e profesionit të avokatit;
- e) të jetë anëtar i dhomës së avokatisë në juridiksionin e së cilës ndodhet zyra e tij e punës.

Neni 26

1. Provimi i kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatit zhvillohet përpara një komisioni me këtë përbërje:

- a) tre anëtarë të caktuar nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë;
 - b) një anëtar i caktuar nga Ministri i Drejtësisë;
 - c) një anëtar i caktuar ndërmjet punonjësve akademikë të Shkollës së Magjistraturës.
2. Rregullat e funksionimit, numri i kandidatëve për avokat, si dhe mënyra se si do të zhvillohet provimi, vendosen rast pas rasti nga Këshilli Drejtues i Dhomës së Avokatisë.

Neni 27

1. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, kryesisht ose mbi kërkesën e personit që kërkon të ushtrojë profesionin e avokatit, ka të drejtë që ta përjashtojë nga detyrimi i pjesëmarrjes në provimin e kualifikimit, nëse për këtë vendoset me shumicën e votave të fshehta të të gjithë anëtarëve të saj.

2. Përrjashtimi nga detyrimi i pjesëmarrjes në provimin e kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatit mbështetet në kohëzgjatjen e tyre në ushtrimin e profesionit të juristit, aftësitë profesionale të treguara dhe edukimin e posaçëm profesional e akademik. Rregulla të hollësishme për kushtet dhe kriteret e përrjashtimit nga provimi i kualifikimit caktohen nga Statuti i Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

3. Vendimi për përrjashtimin nga detyrimi, për dhënien e provimit të kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatit, miratohet nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 28

Personat që kanë punuar jo më pak se 2 vjet si gjyqtarë, prokurorë, noterë, si dhe jo më pak se 3 vjet në pozicionin e drejtuesit, këshilltarit apo specialistit të strukturave juridiko-profesionale të Presidencës, Kuvendit, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, aparatit të Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë, avokatët e strukturave të Avokaturës së Shtetit, si dhe në atë të punonjësit akademik të brendshëm të lëndëve juridike në shkollat e larta, përrjashtohen nga përmbushja e detyrimit të parashikuar në shkronjën "b" pika 1 të nenit 25 të këtij ligji.

Neni 29

1. Avokati ka të drejtë të ketë një ose më shumë asistentë.
2. Asistentët zgjidhen nga vetë avokati ndërmjet personave të diplomuar juristë, që nuk kanë marrë lejen për ushtrimin e profesionit të avokatit.
3. Avokati ka për detyrë që, brenda 15 ditëve nga ajo e lidhjes së marrëdhënieve të punës me asistentin, të depozitojë dokumentacionin e tij për [regjistrim n](#)ë dhomën e avokatisë ku është anëtar, në Dhomën Kombëtare të Avokatisë, si dhe në Ministrinë e Drejtësisë.
4. Me autorizimin me shkrim të avokatit dhe, kurdoherë, me [pëlqimin](#) me shkrim të klientit, asistenti përfaqëson ose mbron të interesuarit në periudhën hetimore, në gjykimin e kundërvajtjeve penale dhe në seancat përgatitore për çështjet civile.

Neni 30

1. Kërkesa për ushtrimin e profesionit të avokatit i drejtohet, si rregull, dhomës së avokatisë ku kërkuesi ka vendbanimin e tij.
2. Dhoma e avokatisë, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për ushtrimin e profesionit të avokatit, duhet të marrë në shqyrtim kërkesën dhe, së bashku me mendimin e saj, e përcjell për shqyrtim në Këshillin Drejtues të [Dhomës](#) Kombëtare të Avokatisë.
3. Këshilli Drejtues i [Dhomës](#) Kombëtare të Avokatisë, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, duhet të njoftojë kërkuesin, nëse ai i plotëson kushtet për të marrë pjesë në provimin e kualifikimit, si dhe për ditën e caktuar për zhvillimin e tij.

Neni 31

1. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë shpall datat e zhvillimit të provimeve të kualifikimit, për ushtrimin e profesionit të avokatit, për atë vit kalendarik.
2. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, brenda muajit janar të çdo viti, miraton edhe përfaqësuesit e tij në komisionin e provimit të kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatit.

Neni 32

Në qoftë se kandidati për avokat nuk arrin të grumbullojë minimumin e pikëve të nevojshme kualifikuese për ushtrimin e profesionit të avokatit, ai mund të marrë pjesë përsëri në provimin kualifikues, me kusht që të kryejë edhe gjashtë muaj të tjerë periudhë stazhi si asistent pranë një

avokati.

Neni 33

1. Komiteti Disiplinor i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, kryesisht ose me propozimin e dhomës së avokatëve, organeve gjyqësore, të prokurorisë, Ministrit të Drejtësisë apo të personave të interesuar, është organi kompetent për heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit.

Komiteti Disiplinor i Dhomës Kombëtare të Avokatisë përgjigjet dhe kontrollohet nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, sipas rregullave të përcaktuara në statut ose nga vetë ai.

2. Rregulla të hollësishme për përbërjen dhe funksionimin e Komitetit Disiplinor dhe të komisioneve të posaçme disiplinore të Dhomës Kombëtare të Avokatisë caktohen në statut.

3. Leja për ushtrimin e profesionit të avokatit hiqet, kur vërtetohet një nga rastet e mëposhtme:

a) është lëshuar në kundërshtim me kushtet e parashikuara në nenin 25 të këtij ligji;

b) vërtetohet se avokati ka përdorur dokumente të falsifikuara për të marrë lejen e ushtrimit të profesionit të avokatit;

c) vuan nga një sëmundje, sëmundje mendore ose dëmtime fizike, të cilat bëjnë të pamundur ushtrimin normal të profesionit;

ç) është deklaruar i falimentuar;

d) nuk ka paguar kontributin e anëtarësisë;

dh) ka shkelur rëndë ose në mënyrë të përsëritur rregullat për ushtrimin e profesionit të avokatit;

e) është dënuar nga gjykata për kryerjen e veprave penale, me dashje, që janë parashikuar në "Kodin e etikës së avokatit".

4. Për avokatët e huaj, përveç rasteve të parashikuara më sipër në këtë nen, heqja e lejes së posaçme për ushtrimin e profesionit të avokatit në Republikën e Shqipërisë, bëhet edhe në rastin kur atij i është hequr leja e ushtrimit të profesionit të avokatit në shtetin e tij.

5. Shqyrtimi i çështjes dhe dëgjimi i avokatit të proceduar disiplinarisht, nëse është i mundshëm, bëhet nga një komision i posaçëm disiplinor, me detyrë të mbyllura.

6. Avokati i proceduar disiplinarisht ka të drejtë të marrë pjesë dhe të dëgjohet nga komisioni disiplinor, personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të caktuar prej tij, ndërmjet avokatëve.

7. Avokati përfaqësues duhet të jetë i pranishëm gjatë gjithë periudhës së shqyrtimit të çështjes.

8. Komisioni Disiplinor duhet të marrë dhe të publikojë vendimin e tij brenda 10 ditëve, duke filluar nga dita e parë e shqyrtimit të procedimit disiplinor.

KREU VI REGJISTRAT E DHOMËS KOMBËTARE TË AVOKATISË

Neni 34

1. Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Ministria e Drejtësisë mbajnë pranë tyre regjistrin e të gjithë avokatëve, si dhe administrojnë dokumentacionin përkatës, që lidhet me të drejtën e ushtrimit të profesionit të avokatit.

2. Regjistri i avokatëve, për secilin prej tyre, përmban të dhënat e mëposhtme:

a) identitetin;

b) datëlindjen;

c) shkollën e lartë ku avokati është diplomuar si jurist;

ç) titujt dhe gradat shkencore;

d) nivelin e njohurive në gjuhë të huaja;

dh) dhomën e avokatisë ku është anëtar, në juridiksionin e së cilës, si rregull, avokati ushtron profesionin e tij;

e) adresën e zyrës së tij ose adresën dhe emrin e zyrës së avokatisë, nëse avokati është anëtar i saj;

ë) të dhëna mbi thyerjen e disiplinës.

3. Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë ka në kompetencë të vendosë që, përveç të dhënave të treguara në pikën 2 të këtij neni, në regjistrin e avokatëve të pasqyrohen edhe të dhëna të tjera.

4. Dhoma e avokatisë, për juridiksionin e saj, mban regjistrin e avokatëve dhe dokumentacionin përkatës, sipas listës së të dhënave të treguara në këtë nen.

Neni 35

1. Dhoma Kombëtare e Avokatisë, dhomat e avokatisë për juridiksionin e saj, si dhe Ministria e Drejtësisë, mbajnë regjistrin e asistentëve, si dhe administrojnë dokumentacionin përkatës për ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

2. Regjistri i asistentëve, për secilin prej tyre, përmban të dhënat e mëposhtme:

a) adresën e zyrës së tij ose adresën dhe emrin e zyrës së avokatisë, nëse avokati është anëtar i saj;

b) identitetin;

c) datëlindjen;

ç) shkollën e lartë ku asistenti është diplomuar si jurist;

d) titujt dhe gradat shkencore, nëse ka të tilla;

dh) nivelin e njohurive në gjuhë të huaja;

e) datën e fillimit dhe të përfundimit të periudhës së stazhit, të nevojshme për pranimin e pjesëmarrjes së tij në provimin e kualifikimit, për ushtrimin e profesionit të avokatit;

ë) datat e provimit të kualifikimit, në rast se nuk është kualifikuar;

f) emrin dhe adresën e avokatit, pranë të cilit ushtron veprimtarinë e tij si asistent.

2. Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë ka në kompetencë të vendosë që, përveç të dhënave të treguara në pikën 2 të këtij neni, në regjistrin e asistentëve të pasqyrohen edhe të dhëna të tjera.

KREU VII AVOKATI I HUAJ

Neni 36

1. Shtetasi i huaj mund të ushtrojë profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë nëse plotëson kushtet e parashikuara në këtë ligj për shtetasit shqiptarë dhe pas dhënies së provimit të kualifikimit në gjuhën shqipe.

2. Rregullat për dhënien e lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit të huaj përcaktohen nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

KREU VIII ANKIMET DHE DISIPLINA

Neni 37

1. Ankesat për çdo sjellje ose veprim të avokatit i drejtohen kryetarit të dhomës së avokatisë.

2. Ankimi kundër avokatit mund të bëhet nga:

a) çdo person që mbrohet, përfaqësohet ose ndihmohet juridikisht prej tij;

b) çdo person i tretë, që pretendon se është dëmtuar nga sjellja ose veprimet e avokatit.

3. Këshilli drejtues i dhomës së avokatisë duhet të shqyrtojë dhe të zgjidhë ankesën, duke u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së saj. Me të njëjtat kritere të shqyrtohet rasti i ankimit të një avokati kundër një avokati tjetër.

4. Në rast se, në përfundim të shqyrtimit të ankesës, rezultojnë se rrethanat e paraqitura në të janë të vërteta, avokatit përgjegjës i kërkohet që:

a) të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të zgjidhë problemin në fjalë;

b) të kompensojë dëmin e shkaktuar ankuesit, në masën që çmohet e drejtë nga rrethanat që rezultojnë nga shqyrtimi i ankesës.

5. Avokati ose ankuesi, në qoftë se nuk bien dakord me vendimin, kanë të drejtën e apelimit në komitetin disiplinor të dhomës së avokatisë.

6. Apeli duhet t'i paraqitet me shkrim sekretarit të dhomës brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit.

Neni 38

1. Avokati i nënshtrohet procedimit disiplinor në rast se pretendohet:

a) se ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e avokatisë;

b) se ka vepruar në kundërshtim me rregullat e parashikuara në statut, në "Kodin e etikës së avokatit" dhe me rregullat e tjera, të vendosura nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe dhomat e avokatisë;

c) se është bërë apelim nga ankuesi ndaj një vendimi, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit 37 të këtij ligji.

2. Procedimin disiplinor të avokatit kanë të drejtë ta kërkojnë personat e treguar në pikën 2 të nenit 37 të këtij ligji, si dhe organet drejtuese të dhomës së avokatisë. Ministri i Drejtësisë, nëse çmon se ka vend për procedim disiplinor, mund t'i sugjerojë Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë ndërmarrjen e një veprimi të tillë.

Neni 39

1. Procedimi disiplinor ndaj avokatit realizohet nga komiteti disiplinor i dhomës përkatëse ku ai është anëtar.

2. Komiteti disiplinor përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe jo më shumë se pesë avokatë me përvojë, të zgjedhur nga këshilli i përgjithshëm i dhomës së avokatisë.

3. Komiteti disiplinor shqyrton dhe gjykon çështjet nëpërmjet një komisioni disiplinor, të përbërë nga jo më pak se tre dhe jo më shumë se pesë anëtarë. Përbërja e komisionit disiplinor caktohet nga këshilli drejtues i dhomës së avokatisë.

Neni 40

1. Procedimi disiplinor fillon me paraqitjen e kërkesës nga subjektet e treguara në pikën 2 të nenit 38 të këtij ligji.

2. Brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës, këshilli drejtues i dhomës së avokatisë cakton përbërjen e komisionit disiplinor dhe, nëpërmjet kryetarit të tij, duhet të njoftojë palën kërkuese dhe avokatin që është subjekt procedimi disiplinor për orën, datën, vendin e zhvillimit të seancës, si dhe për përbërjen e komisionit disiplinor të zgjedhur për shqyrtimin e çështjes.

3. Procedura disiplinore duhet të zhvillohet brenda 30 ditëve nga ajo e paraqitjes së ankesës.

4. Në çdo kohë, por jo më vonë se 7 ditë nga data e caktuar për zhvillimin e seancës, palët mund t'i kërkojnë këshillit drejtues të dhomës së avokatisë, duke paraqitur motive të arsyeshme që:

a) të caktojnë një datë tjetër për zhvillimin e seancës së procedimit disiplinor;

b) të ndryshojnë përbërjen e komisionit disiplinor.

Neni 41

1. Palët në procedimin disiplinor kanë të drejtë të paraqiten dhe të shpjegohen në seancë vetë ose nëpërmjet mbrojtjes dhe përfaqësimit me avokat. Në qoftë se njëra ose të dyja palët nuk paraqiten në seancë pa motive të arsyeshme, komisioni disiplinor shqyrton çështjen dhe merr vendim në mungesë të tyre.

2. Gjatë procedurës ankimore, komisioni disiplinor mund të dëgjojë shpjegime nga palët dhe dëshmitarët e tyre.

3. Shpjegimet e palëve dhe dëshmitë në seancë mund të jepen me gojë ose me shkrim.

4. Komisioni disiplinor mund të marrë në konsideratë dokumentet e paraqitura përpara tij, me cilësinë e provës, si dhe të urdhërojë avokatin që procedohet disiplinarisht, që të paraqesë përpara tij

dosjen ose dokumentet që disponon për çështjen, subjekt gjykimi.

Neni 42

1. Komisioni disiplinor duhet të marrë vendimin e tij dhe ta shpallë atë brenda 10 ditëve. Vendimet në komision disiplinor merren me shumicën votave të anëtarëve të vet.
2. Komisioni disiplinor duhet t'u dërgojë palëve, Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Ministrisë së Drejtësisë kopje të vendimit të shpallur prej tij.

Neni 43

Për shkelje të dispozitave që rregullojnë ushtrimin e profesionit të avokatit, komisioni disiplinor i dhomës së avokatisë mund të japë një nga masat disiplinore të mëposhtme:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) gjobë nga 5 000 (pesë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
- c) pezullimin e lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet;
- ç) i propozon Komitetit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit.

Neni 44

1. Komisioni disiplinor, përveç masave të përmendura më sipër, mund të urdhërojë avokatin e proceduar disiplinarisht që t'u paguajë palëve të dëmtuara një shumë të hollash si kompensim për dëmin e shkaktuar.

2. Komisioni disiplinor mund të urdhërojë avokatin e proceduar disiplinarisht, që të paguajë shpenzimet e palëve të tjera dhe të dhomës së avokatisë për përballimin e çështjes disiplinore në fjalë.

Neni 45

1. Palët pjesëmarrëse në procedimin disiplinor, brenda dhjetë ditëve nga shpallja e vendimit të komisionit disiplinor, mund të bëjnë apel në Komitetin Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

2. Avokati, brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, mund ta apelojë vendimin e Komitetit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Neni 46

Dhoma Kombëtare e Avokatisë duhet të regjistrojë vendimet e procedurave disiplinore dhe të njoftojë Ministrinë e Drejtësisë për këto vendime. Regjistrat duhet të jenë të hapura për t'u parë nga çdo avokat.

Neni 47

1. Çdo avokat dhe çdo zyrë avokatie duhet të kenë një vulë.
2. Vula duhet të tregojë titullin "avokat", identitetin e avokatit ose avokatëve, në rastin e një zyre avokatie, adresën e zyrës.

KREU IX DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 48

1. Ministria e Drejtësisë kujdeset që veprimtaria e avokatisë të ushtrohet normalisht dhe në përputhje me ligjin.
2. Rregullat e hollësishme për ushtrimin e profesionit të avokatit, në përputhje me këtë ligj,

caktohen në statutin dhe në "Kodin e etikës së avokatit", të miratuara nga Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

3. Ministri i Drejtësisë dhe Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, pasi marrin mendimin e Ministrisë së Financave, caktojnë tarifën dhe shpërblimin të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike.

Neni 49

1. Avokatët, që kanë fituar të drejtën për ushtrimin e profesionit të avokatit përpara hyrjes në fuqi të këtij ligj, nuk i nënshtrohen detyrimeve për pjesëmarrjen dhe kalimin me sukses të provimit kualifikues, të parashikuar nga ky ligj.

2. Organet drejtuese të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe të dhomave të avokatëve vazhdojnë veprimtarinë e tyre deri në përfundim të afateve, të parashikuara në ligjin nr. 7827, datë 31.5.1994 "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë".

3. Procedurat e emërimit si asistentë pranë një avokati dhe periudha e kryerjes së stazhit nga ana e tyre, për personat që i kanë përmbushur ato përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme edhe për efekt të vlefshmërisë së emërimit si asistent dhe ecurisë së afatit njëvjeçar të punës së tyre, të parashikuara nga nenet 25 shkronja "b" dhe 29 të këtij ligji.

Neni 50

Dispozitat e Statutit dhe të "Kodit të etikës së avokatit" të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, të miratura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen kur nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 51

Ligji nr. 7827, datë 31.5.1994 "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë", shfuqizohet.

Neni 52

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3923, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

V E N D I M Nr.523, datë 1.8.2003

PËR NJOHJEN DHE EKVIVALENTIMIN E DIPLOMAVE DHE TË CERTIFIKATAVE, TË FITUARA NË SHKOLLAT E LARTA, TË HUAJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 43 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Njohjen e diplomave dhe të certifikatave të fituara në shkollat e larta, të huaja, nga shtetas shqiptarë dhe të huaj.

2. Njohja akademike e diplomave dhe certifikatave, të fituara në shkollat e larta, të huaja, nga shtetas shqiptarë dhe të huaj, të jetë:

a) e drejtpërdrejtë, kur ato janë të vendosura me emërtim për njohje të ndërsjellë, në marrëveshje dypalëshe të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë me vendet e tjera;

b) e ekuivalentuar, kur ato nuk janë të përfshira me emërtim në marrëveshje ndërqeveritare dhe nuk kanë nevojë për plotësim diference, sipas shkronjës "c" të këtij neni;

c) me plotësim diferencash, të verifikuara.

3. Njohja akademike e diplomave dhe certifikatave të fituara në shkollat e larta, të huaja, nga shtetas shqiptarë dhe të huaj, të bëhet nga komisione ad-hoc, të caktuara me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, në përbërje të të cilave të jenë juristë dhe specialistë të fushës.

4. Kriteret dhe procedurat për njohjen e diplomave dhe të certifikatave, të fituara në shkollat e larta, të huaja, nga shtetas shqiptarë dhe të huaj dhe veprimtaria e këtyre komisioneve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M
Nr.524, datë 1.8.2003

PËR HAPJEN E SHKOLLËS PASUNIVERSITARE PRANË AKADEMISË SË POLICISË
"ARBEN ZYLYFTARI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 paragrafi i shtatë, 24, 37 e 38 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Hapjen e shkollës pasuniversitare (SHPU), me drejtim "Rend dhe siguri publike", për vitin akademik 2003-2004 dhe në vazhdim, pranë Akademisë së Policisë "Arben Zylyftari".

2. SHPU-ja të administrojë të ardhurat që mbledh sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi për mbulimin e shpenzimeve të veta.

3. Tarifa e shkollimit të jetë 2000 (dy mijë) lekë. Tarifa e regjistrimit të përcaktohet nga Ministri i Rendit Publik.

4. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M
Nr.526, datë 1.8.2003

Për pranimin në universitetet dhe në shkollat e larta për vitin akademik 2003-2004, në sistemin me shkëputje nga puna dhe për tarifën e shkollimit po për këtë vit akademik

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31 e 42 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kuota e përgjithshme e pranimeve në universitetet dhe shkollat e larta për vitin akademik 2003-2004, në sistemin me shkëputje nga puna, të jetë 10 941 dhe të ndahet:

a) Kuota e pranimeve të reja	10 671
b) Kuota për degë të dytë dhe vite të ndërmjetme	250
c) Kuota për shtetasit e huaj	20

2. Kuota e pranimeve të reja përbëhet nga:

a) Kuota kryesore	9 474
b) Kuota dytësore	927
c) Kuota për shqiptarët nga trojet jashtë vendit	270

3. Kuota e pranimeve të reja ndahet për shkollat e larta, universitetet dhe degët sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Kuotat kryesore ndahen për shkollat e larta, universitetet dhe degët sipas tabelës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Kuotat dytësore, të përcaktuara në tabelën nr.3, që i bashkëlidhen këtij vendimi, u nënshtrohen tarifave të veçanta të shkollimit. Nga këto kuota përfitojnë, sipas renditjes zbritëse në listën e rezultateve të konkurrimit, ata kandidatë, të cilët kanë konkurruar, por nuk kanë fituar.

Vlerat e tarifave të veçanta të shkollimit për vitin akademik 2003-2004 të jenë sa ato të përcaktuara në udhëzimin nr.15, datë 9.6.2000 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe të Ministrit të Financave "Për tarifën e veçantë të shkollimit për kuotat dytësore për vitin akademik 2000-2001, në sistemin me shkëputje nga puna".

6. Kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit: Kosovë, Maqedoni, Mali i zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë, konkurrojnë ndërmjet tyre për kuotat e pranimi, të përcaktuara sipas degëve që paraqiten në tabelën nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Kuotat e pranimi për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në shkollat e larta dhe universitetet e Republikës së Shqipërisë, të administrohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në bazë të kërkesave të paraqitura pranë shkollave të larta dhe universiteteve.

8. Kuotat e pranimeve për vite të ndërmjetme dhe degë të dytë të administrohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe të shpërndahen sipas kërkesave të paraqitura nga shkollat e larta dhe universitetet.

9. Kandidatët, që do të vazhdojnë studimet në një degë të dytë, e fitojnë atë pa konkurs, sipas modaliteteve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe u nënshtrohen tarifave të shkollimit. Masa e tarifës së shkollimit për degë të dytë është e barabartë me tarifën e shkollimit për kuotat dytësore, të përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi.

10. Tarifa e shkollimit për vitin akademik 2003-2004 të jetë në masën 7 000 (shtatë mijë) lekë për studentët e kurseve të para. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët e kurseve të tjera, më të larta (2-të, 3-të, 4-ët, 5-të dhe 6-të), në këtë vit akademik, të jetë 2 500 mijë (dy mijë e pesëqind) lekë.

11. Mënyrat e plotësimit të kuotave të përcaktuara të pikës 1 (një) të këtij vendimi, të përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në bashkëpunim me shkollat e larta dhe universitetet.

12. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**KUOTA E PERGJITHSHME E PRANIMEVE TE REJA
PER VITIN AKADEMIK 2003-2004**

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	SHLI	Σ
1	Histori	116											116
2	Gjeografi	75											75
3	Histori-Gjeografi				95	69		105					269
4	Gjuhe letersi	122			126	69		173					490
5	Hist-Gjeog. Edukate Qytetare				75								75
6	Anglisht	144			65	70	59	95	80				513
7	Frengjisht	92			35								127
8	Italisht	98			53	27		61	60				299
9	Gjuhe slave ballkan	23											23
10	Gjermanisht	74			45			62					181
11	Gjuhe letersi greke	25				32							57
12	Gjuhe Turke	13											13
13	Cikli i ulet				180	68	83	196	150				677
14	Cikli i ulet parashkollor				95	70	67	74	50				356
15	Fizikulture										128		128
16	Matematike	104					35	105					244
17	Fizike	104						105					209
18	Matematike-Fizike				105	60			50				215
19	Biologi-Kimi	108			113	70		116					407
20	Kimi e pergjithshme	40											40
21	Kimi ushqimore	43											43
22	Kimi industriale	36											36
23	Informatike	70						39	33				142
24	Gazetari	69											69
25	Pune sociale	91											91
26	Filozofi-sociologji	92					49						141
27	Psikologji+Pedagogji	64							20				84
28	Shkencat politike	62											62
29	Drejttesi	151						117	100				368
30	Art skenik									44			44
31	Arte figurative									37			37
32	Muzike									96			96
33	Mjekesi	220											220
34	Stomatologji	80											80
35	Farmac	49											49
36	Infermieri				87	70	124	105	160			193	739
37	Administrim-Biznes	350			101	59	54	72					636
38	Ekonomist	62							121				183
39	Informatike Ekonomike	50											50
40	Finance	350			101	73	57	72					653
41	Marketing						54	72	121				247
42	Turizem						54						54
43	Drejtimi i Fermave dhe AGB				150		30						180
44	Ekonomi dhe Politike Agrare				149								149
45	Mekanike		127										127
46	Metalurgji		33										33
47	Tekstil		55										55
48	Elektrik		123										123
49	Elektronik		125										125
50	Ndertim		135										135
51	Arkitekture		93										93
52	Hidroteknike		45										45
53	Topogjeodezi		37										37
54	Inzhinieri ambienti		35										35
55	Gjeol. Min. Ngurte		51										51
56	Gjeofizike		31										31
57	Inzhinieri nafte		50										50
58	Miniera		51										51
59	Inzhinieri detare								40				40
60	Navigacion								40				40
61	Vreshtari,Enologji			26									26
62	Veterinari		91										91
63	Hortikulture dhe M. Bimesh			72									72
64	Insh. Agrar dhe P. Bimor			60			75						135
65	Insh. Agrar ne Zootekn			36									36
66	Akuakulture dhe M. Peshkimi			36									36
67	Insh. Mjedis			60									60
68	Teknolog Ushqimor			60									60
69	Teknik i Larte, Konservim Prod. Buq			26									26
70	Insh. Pyesh			46									46
71	Insh. P. Druri			45									45
TOTALI		2977	991	857	1276	737	741	1569	1025	177	128	193	10671

**KUOTA DYTËSORE E PRANIMEVE TE REJA
PER VITIN AKADEMIK 2003-2004**

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	SHLI	Σ
1	Histori	99											99
2	Gjeografi	66											66
3	Histori-Gjeografi				84	62		95					241
4	Gjuhe leterse	109			111	62		155					437
5	Hist-Gjeog. Edukate Qytetare				66								66
6	Anglisht	127			57	63	50	85	73				455
7	Frengjisht	83			30								113
8	Italisht	89			46	25		55	54				269
9	Gjuhe sllave ballkan	21											21
10	Gjermanisht	67			39			55					161
11	Gjuhe leterse greke	23				30							53
12	Gjuhe Turke	12											12
13	Cikli i ulet				161	62	72	175	136				606
14	Cikli i ulet parashkollor				84	63	59	65	45				316
15	Fizikulture										112		112
16	Matematike	100					32	95					227
17	Fizike	100						95					195
18	Matematike-Fizike				93	60			45				198
19	Biologji-Kimi	98			101	63		105					367
20	Kimi e pergjithshme	35											35
21	Kimi ushqimore	37											37
22	Kimi industriale	33											33
23	Informatike	59						35	30				124
24	Gazetari	60											60
25	Pune sociale	81											81
26	Filozofi-sociologji	81					43						124
27	Psikologji+Pedagogji	54							20				74
28	Shkencat politike	54											54
29	Drejttesi	133						105	90				328
30	Art skenik									36			36
31	Arte figurative									33			33
32	Muzike									88			88
33	Mjekesi	192											192
34	Stomatologji	68											68
35	Farmaci	41											41
36	Infermieri				76	63	108	95	144			166	652
37	Administrim-Biznes	315			90	54	48	65	110				682
38	Ekonomist	54											54
39	Finance	315			90	66	50	65					586
40	Informatike Ekonomike	45											45
41	Marketing						48	65					113
42	Turizem						48		110				158
43	Drejtimi i Fernalve dhe AGB			125									125
44	Ekonomi dhe Politike Agrare			125			27						125
45	Mekanike		123										123
46	Metalurgji		30										30
47	Tekstil		50										50
48	Elektrik		108										108
49	Elektronik		108										108
50	Ndertim		118										118
51	Arkitekture		81										81
52	Hidroteknike		40										40
53	Topogjeodezi		32										32
54	Inzhinieri ambienti		30										30
55	Gjeol. Min. Ngurte		45										45
56	Gjeofizike		27										27
57	Inzhinieri nafte		45										45
58	Mimera		45										45
59	Inzhinieri detare								36				36
60	Navigacion								36				36
61	Insh. Agrar, Hortikult dhe Mbim.			60									60
62	Insh. Agrar dhe P. Bimor			50			66						116
63	Zootek. Dhe B. Bletoral			30									30
64	Akuakulture dhe M. Peshkimi			30									30
65	Insh. Mjedisi			50									50
66	Tek. Ushqimor			50									50
67	Tek. I Larte dhe Kons. P. Bujq.			20									20
68	Enologji, Vreshtari			20									20
69	Insh. Pyjesh			40									40
70	Insh. Perp. Druri			40									40
71	Veterinari			75									75
	TOTALI	2651	882	715	1128	673	651	1410	929	157	112	166	9474

**KUOTA DYTËSORE E PRANIMEVE TE REJA
PER VITIN AKADEMIK 2003-2004**

Tabela Nr. 3

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	SILI	Σ
1	Histori	11											11
2	Gjeografi	7											7
3	Histori-Gjeografi				9	6		9					24
4	Gjuhe leterse	12			12	6		15					45
5	Hist-Gjeog. Edukate Qytetare				7								7
6	Anglisht	14			6	7	6	8	7				48
7	Frengjisht	9			3								12
8	Italisht	9			5	2		5	6				27
9	Gjuhe slave ballkan	2											2
10	Gjermanisht	7			4			5					16
11	Gjuhe leterse greke	2				2							4
12	Gjuhe Turke	1											1
13	Cikli i ulet				17	6	8	16	14				61
14	Cikli i ulet parashkollor				9	7	6	6	5				33
15	Fizikulture						3	9			13		13
16	Matematike							9					12
17	Fizike							9					9
18	Matematike-Fizike				10				5				15
19	Biologji-Kimi	10			10	7		10					37
20	Kimi e pergjithshme	4											4
21	Kimi ushqimore	4											4
22	Kimi industriale	3											3
23	Informatike	6						3	3				12
24	Gazetari	6											6
25	Pune sociale	9											9
26	Filozofi-sociologji	9					4						13
27	Psikologji	6											6
28	Shkencat politike	6											6
29	Drejtësi	15						10	10				35
30	Art skenik												0
31	Arte figurative												0
32	Muzike												0
33	Mjekësi	22											22
34	Stomatologji	8											8
35	Farmacj	4											4
36	Infermieri				8	7	12	9	16			17	69
37	Administrim-Biznes	32			9	5	5	6	11				68
38	Ekonomet	6											6
39	Finance	32			9	7	5	6					59
40	Marketing						5	6					11
41	Informatike Ekonomike	5											
42	Turizem						5		11				16
43	Drejtimi i Fermave dhe AGB			12			3						15
44	Ekonomi dhe Politike Agrare			12									12
45	Mekanike	2											2
46	Metalurgji	3											3
47	Tekstil	5											5
48	Elektrik	12											12
49	Elektronik	12											12
50	Ndërtim	13											13
51	Arkitekture	9											9
52	Hidroteknike	4											4
53	Topogjeodezi	3											3
54	Inzhinieri ambienti	3											3
55	Gjeol. Min. Ngurte	5											5
56	Gjeofizike	3											3
57	Inzhinieri nafte	5											5
58	Miniera	5											5
59	Inzhinieri detare								4				4
60	Navigacion								4				4
61	Hortikulture dhe M. Bimesh			6									6
62	Insh. Agrar, Prodh. Bimor			5			7						12
63	Insh. Agrar, Zooteknj			3									3
64	Akuakulture dhe M. Peshkimi			3									3
65	Insh. Mjedisi			5									5
66	Teknolog ushqimor			5									5
67	Tek. i Larte, Kons. P. Bujq.			4									4
68	Vreshtari, Enologji			4									4
69	Insh. Pyjesh			4									4
70	Insh. Perpunim Druri			4									4
71	Veterinari			8									8
	TOTALI	261	84	75	118	62	69	132	96	0	13	17	927

Tabela Nr.4

		KOSOVA						MAQEDONI						MALITIZI						*									
Nr.	DEGA	UT	AA	UBT	SHLI	UGJ	UE	UPT	UT	UPT	UBT	UE	AA	UK	UT	UPT	USH	AA	UT	UPT	UBT	AA	USH	AS	SHL	Σ			
1	Histori	3							1							1				1						6			
2	Gjeografi	1																		1						2			
3	Histori-Gjeografi					1	1						1										1			4			
4	Gjuhe letersi					1	1					2						2		1				1		8			
5	It-Gje. Eduk. Oyt.						1					1														2			
6	Anglisht						1					1			3	2		1		1				1		10			
7	Frengjisht						1					1														2			
8	Italisht						1					1												1		3			
9	Gjuhe slave ballk.																									0			
10	Gjermanisht							1				1						1						1		4			
11	Gjuhe let. greke																									0			
12	Gjuhe turke																									0			
13	Cikli i ulet						1					1			3			4						1		10			
14	Cikli i ulet parashk.						1					1			2			2						1		7			
15	Fizikulture																								3	3			
16	Matematike								1							2				1				1		5			
17	Fizike								1							2				1				1		5			
18	Matemat-Fizike						1					1														2			
19	Biologji-Kimi						1					1												1		3			
20	Kimi e përgjithme								1																	1			
21	Kimi ushqimore	1							1																	2			
22	Kimi industriale																									0			
23	Informatike	1							1							2				1				1		6			
24	Gazetari	1														1										3			
25	Punë sociale																			1						1			
26	Filozofi-sociologji	1							1					2												4			
27	Psikologji	1							1							1				1						4			
28	Shkencat politike	1																								2			
29	Drejtesi								1							1		1		1				1		5			
30	Art skenik		4										2						1				1			8			
31	Arte figurative		1										1						1							4			
32	Muzike		4										2										2			8			
33	Mjekesi	3							1							1				1						6			
34	Stomatologji	1							1							1				1						4			
35	Farmaci	1							1							1				1						4			
36	Infermieri				5		3							4										1	5	18			
37	Vreshtari-Enologji																									0			
38	Administ-Biznes						2		1					1	1					1				1		7			
39	Ekonomist															1				1						2			
40	Finance						2								2	2				1				1		8			
41	Marketing														1									1		2			
42	Turizem														1											1			
43	Drejt i Fer&AGB			8								2											3			13			
44	Ekon&Pol. Agr			7								2											3			12			
45	Mekanike							2																		2			
46	Elektrik							2																		3			
47	Tek. Lartë Elekt.																				1					0			
48	Elektronik							3		1							1									5			
49	Ndërtim							2									1				1					4			
50	Arkitekture							2									1									3			
51	Hidroteknike							1																		1			
52	Topogjeodezi							1													1					2			
53	Inxhin ambientit							2																		2			
54	Gjeo.Min.Ngurte							1																		1			
54	Gjeofizike									1																1			
55	Inxhinieri naftë																									0			
56	Miniera																				1					1			
57	Hort dhe M. Bim.			4								1										1				6			
58	Inxh. Ag. P. Bim			3								1			2						1					7			
59	Zootekni			1								1									1					3			
60	Akuak. M. Peshk.			1								1										1				3			
61	Inxh. Mjedisë			3								1										1				5			
62	Tek. Ushqimor			3								1										1				5			
63	Kons. P. Bujq.			1								1														2			
64	Vresht. Enolo.			1								1														2			
65	Inxh. Druri			1																						1			
66	Inxh. Pyjesh			1								1														2			
67	Veterinari			5								1											2			8			
TOTALI		15	9	39	5	2	18	16	13	2	14	12	5	21	19	3	11	2	18	4	14	4	16	3	5	270			

V E N D I M
Nr.548, datë 1.8.2003

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT LIMIT TË PUNONJËSVE TË SEKTORIT TË
MBLEDHJES SË ARMËVE, TË MUNICIONEVE DHE MATERIALEVE TË TJERA
LUFTARAKE, NË MINISTRINË E RENDIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, pika 2 e 11 të ligjit nr.9018, datë 6.3.2003 "Për mbledhjen e armëve, të municioneve dhe të materialeve të tjera luftarake" dhe të nenit 8 të ligjit nr.8939, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Numri limit i punonjësve të sektorit të mbledhjes së armëve, të municioneve e materialeve të tjera luftarake të jetë 30 veta dhe të përballohet nga numri limit i punonjësve, i miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.
2. Struktura dhe përbërja organike e këtij sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe në Drejtorinë e Policisë së qarqeve, përcaktohen nga Ministri i Rendit Publik.
3. Pajisjet e nevojshme, materiale e logjistike dhe fondet e nevojshme për funksionimin normal të këtij sektori të sigurohen nga Ministria e Rendit Publik.
4. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 4.8.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë